183. Fisi, njëkohësisht ka ndezur 2 fishekzjarre, njëra ngjyrë ari, tjetra ngjyrë argjendi. Fishekzjarret kanë shpërndarë gjithsej 20 xixa. Ajo me ngjyrë ari ka shpërndarë 6 xixa më shumë se ajo ngjyrë argjendi. Sa xixa ka shpërndarë fishekzjarrja me ngjyrë ari?


- a) 9 b) 10 c) 12 ç) 13 d) 15

184. Learti ka 3 topa me ngjyra të ndryshme (të bardhë, të zezë dhe ngjyrë hiri). Topat me ngjyrë të njëjtë kanë masë të njëjtë. Sipas figurës më poshtë sa është masa e topit të bardhë?



- a) 3 kg b) 4 kg c) 5 kg ç) 6 kg d) 7 kg

185. Dea dëshiron të nxjerrë 5 forma të ndryshme nga 5 kutitë e paraqitura më poshtë. Cilën formë duhet Lea ta nxjerrë nga kutia 4, nëse nga secila kuti mundet të nxirret vetëm një formë?




- a) b) c) ç) d)

186. Figura është e përbërë prej 18 kubeve, prej të cilave disa janë të bardha, disa të zeza dhe disa ngjyrë hiri. Nëse pjesët me ngjyrë të bardhë dhe të zezë janë të formës , atëherë çfarë forme do të ketë pjesa me ngjyrë hiri?

- a) b) c) ç) d)

187. Pesë sfera rrokullisen në kahjen që është përcaktuar me shigjetat. Ato fillojnë të rrokullisen njëkohësisht. Kur përplasen 2 sfera që rrokullisen në



kahje të kundërt, më e madhja e gëlltit më të voglën dhe e rrit vlerën e saj për vlerën e më të voglës. Sfera më e madhe vazhdon rrokullisjen sipas kahjes fillestare të saj (shih figurën). Cili është rezultati përfundimtar i përplasjes së 5 sferave të dhëna më lart?




- a) b) c) ç) d)

188. Në arkën e shitores së akulloreve gjendet një sasi e të hollave. Të gjitha akulloret kanë çmim të njëjtë. Pas shitjes së 6 akulloreve, në arkë gjenden 70 €. Pas shitjes së 16 akulloreve në arkë gjenden gjithsej 120 €. Sa € kanë qenë në arkë para fillimit të shitjes së akulloreve?

- a) 20 b) 30 c) 40 ç) 50 d) 60

189. Në figurë është paraqitur ndërtesa e banimit në të cilën janë mbështetur shkallët e zjarrfikësve. Lartësia e 3 shkallëve është dhënë në figurë. Të caktohet lartësia e shkallës së 4.




- a) 12 b) 14 c) 16 ç) 20 d) 22

190. Kutia për ëmbëlsira përmban më pak se 50 ëmbëlsira. Ëmbëlsirat mund t'u ndahen në mënyrë të barabartë 2 fëmijëve, 3 fëmijëve dhe 4 fëmijëve. Ëmbëlsirat nuk mund t'u ndahen 7 fëmijëve sepse duhet të shtohen edhe 6 ëmbëlsira. Sa ëmbëlsira ka në kuti?

- a) 12 b) 24 c) 30 ç) 36 d) 48


191. Secila prej kutive në figurë, përmban banane dhe mollë, por jo edhe njërin edhe tjetrën. Masa e përgjithshme e bananeve është 3 herë më e madhe se masa e mollëve. Në cilat kuti gjenden mollët?



- a) 1 dhe 2 b) 2 dhe 3 c) 2 dhe 4 ç) 3 dhe 4 d) 1 dhe 4


192. Ëndrra dëshiron t'i shkruajë numrat nga 1 deri 9 në tabelën e paraqitur. Shigjetat tregojnë që gjithmonë shkohet prej numrit më të vogël kah numri më i madh. Ëndrra tashmë i ka shkruar numrat 5 dhe 7. Cili numër duhet të shkruhet në vend të ? ?

- a) 2 b) 3 c) 4 ç) 6 d) 8



193. Besa ka 3 peshore dhe disa figura si trekëndësha, katrorë dhe gjashtëkëndësha. Ajo i ka vendosur ato në peshore, sikurse duket në figurën e dhënë. Çka duhet të vendosë ajo në tasin e majtë të peshores së tretë që masat e tasit të majtë dhe tasit të djathtë të jenë të barabarta?


- a) 1 katror b) 2 katrorë c) 1 gjashtëkëndësh
ç) 1 trekëndësh d) 2 trekëndësha



194. Cila është vlera e shprehjes $20 \cdot 1 + 8$

- a) 28 b) 29 c) 180 ç) 209 d) 2018

195. Në figurën e dhënë janë paraqitur rrugë të ndryshme të parkut që të kalohet nga pika A në pikën B. Cila është rruga më e shkurtër?



196. Ora digjitale tregon kohën 18:20. Pas sa minutave ora digjitale do ta tregojë kohën 20:18?

- a) 68 b) 108 c) 118 ç) 128 d) 198


197. Sa rrahë janë vizatuar në figurën e dhënë?

- a) 6 b) 7 c) 8 ç) 9 d) 10



198. Milingona lëviz sipas kahjes së rrugës së vizatuar. Nëse distanca ndërmjet 2 pikave fqinje është 5 dm, në cilën pikë do të mbërrijë milingona pas kalimit të 3 metrave?

- a) A b) B c) C ç) D d) E



199. Dita ka mbledhur 2 numra dyshifrorë. Ajo ka ngjyrosur 2 shifra si në figurë. Sa është shuma e shifrave të ngjyrosura?

- a) 5 b) 7 c) 8 ç) 9 d) 13


200. Lisi lodrat i ka vendosur në 6 kuti në të cilat janë shkruar numrat prej 1,2,3,4,5 6. Në secilën kuti janë vendosur aq lodra sa është numri i shkruar në kuti. Sa lodra i nevojiten Lisit që në secilën kuti të ketë nga 7 lodra?

- a) 15 b) 21 c) 28 ç) 30 d) 42

201. Arta, Bora dhe Jona janë lindur në të njëjtën ditë të vitit, por në vite të ndryshme. Arta është 2 vjet më e madhe se Bora, kurse Bora është 2 vjet më e madhe se Jona. Atëherë sa vjet i ka Arta nëse shuma e viteve të tyre është 45?

- a) 13 b) 14 c) 15 ç) 16 d) 17

202. Figura e mëposhtme përbëhet prej 11 katrorëve. Gjithashtu janë dhënë edhe 2 figura me ngjyrë hiri. Cila nga figurat e ofruara më poshtë mungon, me të cilën së bashku me 2 figurat e dhëna do të mbulohej tërësisht pa u palosur një mbi një, tabela fillestare e dhënë?



203. Petriti librat i paketon në kuti të vogla dhe të mëdha. Në kutinë e vogël mund të paketohen 12 libra, ndërsa tek e madhja 14 libra. Sa kuti më së paku i duhen Petritit, nëse ai i ka 131 libra?

- a) 9 b) 10 c) 11 ç) 12 d) 13

204. Nëna ka 38 sheqerka, ndërsa 4 fëmijët e saj kanë nga 3 sheqerka. Sa sheqerka nëna duhet t'u japë gjithsej fëmijëve të saj, që të gjithë të kenë numër të njëjtë sheqerkash duke përfshirë edhe vetveten?

- a) 28 b) 24 c) 20 ç) 16 d) 12

205. Numri treshifror është “i bukur” po qe se shifra e njësheve është e barabartë me shifrën e qindësheve, kurse shifra e dhjetësheve është më e vogël (505, 939). Sa numra të bukur treshifrorë ka?






- a) 42 b) 43 c) 44 ç) 45 d) 46

206. Numri i pikave te faqet e zarit është prej 1 gjer më 6. Shuma e pikave të faqeve të kundërta është 7. Dy zare të tilla janë paraqitur në figurën e dhënë. Sa është shuma e pikave të faqeve horizontale që nuk duken?




- a) 7 b) 9 c) 11 ç) 13 d) 14

207. Arta ka vendosur mbi tavolinë 3 kube. Mbi kube ka vendosur 2 cilindra dhe mbi ta, një kub. Cili nga konstruksionet e mëposhtme është ai i Artës?



208. Nëna, tortën e ditëlindjes e ka prerë në 2 pjesë të barabarta. Më pas gjysmën e ka ndarë përsëri në 2 pjesë të barabarta. Pjesën më të vogël, përsëri e ka ndarë në 2 pjesë të barabarta. Një copë e tillë ka peshuar 60 g. Sa ka peshuar e tërë torta?



- a) 480 g b) 600 g c) 960 g ç) 1000 g d) 1200

209. Në secilin katror të shprehjes $1 \square 2 \square 2 \square 2$ Lena mund të shënojë vetëm shenjën e mbledhjes dhe të shumëzimit. Cilin numër Lena nuk mund ta fitojë në këtë mënyrë?

- a) 6 b) 7 c) 8 ç) 9 d) 10

210. Stina dëshiron ta ndërtojë kubin me anë të kubëzave. Ajo ka renditur disa kubëza të paraqitura si në figurë. Sa kubëza i duhen Stinës që ta formojë kubin?

- a) 10 b) 17 c) 19 ç) 28 d) 56



211. Në sa mënyra Petriti mund të tregojë se i ka 3 vjet, me ndihmën e gishtave të njëjës dorë?

- a) 5 b) 8 c) 9 ç) 10 d) 15

212. Joni në kompjuterin e tij e ka bërë listën e këngëve të cilat i ka shënuar me k1.mp3, k2.mp3,...k30.mp3. Çdo këngë zgjat 7 minuta. Joni i ka dëgjuar të gjitha këngët pa ndërprerje. Cila këngë ka qenë në radhë gjatë dëgjimit kur kanë kaluar 2 orë pas fillimit të dëgjimit?

- a) k18.mp3 b) k20.mp3 c) k21.mp3 ç) k24.mp3 d) k28.mp3

213. Ora digjitale në ekran i paraqet orët dhe minutat. Sa herë shifra 9 do të paraqitet në ekran për të treguar minutat në intervalin kohor prej 10:00-17:00?

- a) 28 b) 35 c) 36 ç) 42 d) 56

214. Onida dhe 2 shoqet e saj, së bashku kanë 25 vjet. Onida është 1 vjet më e vjetër se Narta. Onida dhe Trendelina së bashku kanë 17 vjet. Sa vjeçe është Onida?

- a) 7 b) 8 c) 9 ç) 10 d) 11

215. Ideali ka zhetona ku janë shënuar numrat 1,2,3,4,5,6,7,8,9. Ai duhet të zgjedhë prej tyre 3 zhetona, ashtu që shuma e numrave të jetë më shumë se 20. Në sa mënyra të ndryshme mund t'i zgjedhë zhetonat Ideali?

- a) 4 b) 5 c) 6 ç) 7 d) 8

216. Mali ka 6 pjesë të puzzles (si në figurë). Cilën figurë do ta fitojë ai, po që se i vendos pjesët në mënyrë të saktë?



- a)  b)  c)  ç)  d) 

217. Cilët nga katrorët e ngjyrosur më poshtë janë identikë? (Katrorët mund të rrotullohen)




- a) 1 me 3 b) 3 me 6 c) 3 me 4 ç) 1 me 4 d) 1 me 6

218. Zdrukthëtari së bashku me ndihmësin e tij duhet të bëjnë 300 korniza për fotografi. Zdrukthëtari bën 18 korniza, ndërsa ndihmësi 12 korniza në ditë. Pas sa ditësh do të kryhet puna?


- a) 10 b) 9 c) 8 ç) 7 d) 6

219. Yllit në të majtë (shih figurën) i mungon një pjesë që të jetë i njëjtë me yllin në të djathtë. Cila pjesë i mungon?




- a) b) c) ç) d)

220. Nëse pllakat e ofruara vendosen në fushën e dhënë në mënyrë që vijat në to, të formojnë së bashku vijë të pandërprerë, cila nga pllakat do të qëndrojë në vendin e ??




- a) b) c) ç) d)

221. Nga fotografia më poshtë, cakto sa kilogramë mat peshorja e 4-t nëse:



- a) 10 kg b) 12 kg c) 13 kg ç) 15 kg d) 18 kg

222. Në figurën më poshtë, është dhënë shtegu nëpër të cilin ka lundruar Mali dhe 4 ishujt rreth të cilëve ka kaluar ai. Rreth cilëve ishujt Mali ka lundruar në kahje të kundërt të lëvizjes së akrepave të orës?



- a) 1 dhe 3 b) 2 dhe 3 c) 3 dhe 4 ç) 1 dhe 2 d) 2 dhe 4

223. Në figurën e dhënë, numrat në katrorë paraqesin prodhimin e numrave në të majtë të tyre dhe numrave që gjenden mbi katrorë. Cili numër qëndron pas shenjës së zemrës?

x	3	?
5	15	35
4	12	♥


- a) 25 b) 27 c) 28 ç) 29 d) 30

224. Në figurën më poshtë janë mbledhur 2 numra, por nuk duken katër shifrat e tyre. Sa është shuma e tyre?

$$\begin{array}{r}
 \text{●} \text{●} \text{●} \\
 + \\
 \text{●} \text{6} \text{3} \\
 \hline
 \text{5} \text{7} \text{2}
 \end{array}$$

- a) 8 b) 9 c) 11 ç) 13 d) 14

225. Faqet e tre kubeve të paraqitura janë shënuar me numra (shih figurën). Shuma e numrave të faqeve të kundërta është 20. Sa është shuma e numrave të faqeve që nuk duken te kubet e dhëna?






- a) 97 b) 98 c) 99 ç) 100 d) 101

226. Figura në të djathtë është formuar prej 5 kubeve me ngjyra të ndryshme në pamjen nga përpara. Si do të duket kjo figurë nëse shikohet nga lart?







- a) b) c) ç) d)

227. Në secilën enë janë të vendosur 5 topa të cilët janë të shënuar me numra. Në cilën enë, shuma e numrave është më e madhe?



228. Anijet e Tomit i kanë zbukurimet në formë të katrorit, trekëndëshit dhe rrethit. Anija e Tomit ka më shumë se një rreth, 2 trekëndësha më shumë se numri i katrorëve. Cila është anija e Tomit?




229. Figura në të djathtë paraqet tortën e ditëlindjes së gjyshit të Malit. Qirinjtë e mëdhenj paraqesin 10 vjet, ndërsa qirinjtë e vegjël 1 vit. Sa vite i ka pasur gjyshi i Malit?



- a) 65 b) 66 c) 67 ç) 76 d) 78

230. Në një park janë 3 drunj, por ketri mund t'i shohë vetëm dy prej tyre, sepse të tjerët janë të fshehur. Në cilën prej pikave të shënuara A, B, C, Ç, D, ndodhet ketri?



- a) në A b) në B c) në C ç) në Ç d) në D

231. Në figurën më poshtë me shenjat e pikëpyetjes janë mbuluar numra të barabartë. Cili numër është në vendin e pikëpyetjes, nëse shuma e gjithë numrave është 18?

$(10) + (?) + (?) + (2) = 18$ a) 1 b) 2 c) 3 ç) 4 d) 5

232. Tabela i ka 30 fusha. Sa fusha do të mbeten të pangjyrosura po qe se ngjyrosen rreshtat 3 dhe 6 si dhe shtyllat C dhe D?

	A	B	C	D	E
1					
2					
3					
4					
5					
6					


- a) 10 b) 12 c) 18 ç) 22 d) 26

233. Fitimi dëshiron ta plotësojë tabelën e dhënë. Ka në dispozicion figura të ndryshme. Cilat do t'i përdorë ai?




- a) 1, 2, 3 b) 1, 2, 4 c) 1, 2, 5 ç) 3, 4, 5 d) 1, 4, 5


234. Arjani e preu imazhin e kërpudhave në gjysmë dhe më pas i vendosi pjesët përsëri së bashku. Cila është një zgjidhje e mundshme për ribashkimin e dy pjesëve?



235. Çmimi i sendiçit dhe lëngut së bashku është 280 denarë, kurse i sendiçit dhe 2 lëngjeve është 360 denarë. Sa është çmimi i një lëngu?


- a) 50 denarë b) 60 denarë c) 70 denarë ç) 80 denarë d) 90 denarë

236. Joni e ndërton shtegun rreth katrorit me pllaka sikurse është paraqitur në figurë. Sa pllaka i nevojiten për ta ndërtuar shtegun rreth katrorit me brinjën 5 nëse  dhe



- a) 10 b) 12 c) 14
ç) 16 d) 18

237. Dinoja kalon nëpër dhoma prej hyrjes kah dalja. Nëpër secilën dhomë mund të kalojë vetëm një herë. Duke kaluar nëpër dhoma ai mbledh numrat me të cilët janë shënuar dhomat. Cila është shuma më e madhe të cilën mund ta mbledhë ai nëse:



- a) 27 b) 29 c) 32 ç) 34 d) 36


238. Për të paraqitur shifrat mund të përdoren edhe fijet e shkrepëses si në figurën më poshtë. Për shembull, për të paraqitur numrin 15, nevojiten 7 fije shkrepëseje dhe i njëjti numër fijesh nevojitet edhe për të formuar numrin 8. Cili është numri më i madh pozitiv, i cili mund të formohet me 7 fije shkrepëseje?



- a) 31 b) 51 c) 74 ç) 711 d) 800


239. Klodiani ngjitet nga fundi i kullës cilindrike në majë të saj (shih figurën). Hapat janë të gjithë të njëjtë. Në figurë paraqiten 9 hapa. Sa hapa nuk duken ?

- a) 9 b) 10 c) 11 ç) 12 d) 13



240. Figura paraqet një pako rreth së cilës janë mbështjellë katër fjongo M,N,P dhe Q. Në çfarë radhe nga e para në të fundit, janë vendosur fjongot?

- a) M,N,Q,P b) N,M,P,Q c) N,Q,M,P
ç) N,M,Q,P d) Q,N,M,P




241. Familja e Arbrit ka një oborr, i cili është me pllaka katrore të ndryshme. Pllakat më të vogla e kanë perimetrin 80 cm. Në oborr Arbri vizatoi një vijë të trashë, siç tregohet në figurë. Sa është gatësia e kësaj vije?



- a) 380 cm b) 400 cm c) 420 cm
 ç) 440 cm d) 1680 cm

242. Artani dëshiron të vizatojë forma në gjashtë kutitë e piramidës së treguar. Çdo kuti duhet t'i përmbajë të gjitha format e vizatuara në dy kutitë që gjenden menjëherë poshtë saj dhe asnjë më shumë. Ai tashmë i ka vizatuar format në disa nga kutitë. Cilat forma duhet t'i vizatojë në kutinë në mes të rreshtit të poshtëm?




- a) b) c) ç) d)

243. Secila nga 5 kutitë përmban mollë ose banane, por jo të dyja. Pesha totale e të gjitha bananeve është 3 herë më e madhe se pesha e të gjitha mollëve. Cilat janë kutitë ku ndodhen mollët?




- a) 1 dhe 2 b) 2 dhe 3 c) 2 dhe 4 ç) 3 dhe 4 d) 1 dhe 4

244. Secili nga numrat 1 deri 9 janë shkruar në katrorët e tabelës së treguar. Shumat e të gjitha çifteve të numrave fqinjë janë paraqitur te tabela. Cili numër duhet të qëndrojë te katrori me ngjyrë hiri?



- a) 4 b) 5 c) 6 ç) 7 d) 8

245. Në figurë janë paraqitur 5 trasta, ku numri i secilës paraqet numrin e monedhave të arit në to. Ato nuk duhet të hapen por duhet të vendosen në arka, ashtu që tek arka më e madhe duhen vendosur 2 herë më shumë monedha se në arkën e vogël. Në sa mënyra mund të bëhet shpërndarja e trastave me monedha?



- a) 1 b) 2 c) 3 ç) 4 d) 5

PJESA III

Ata që duan të dinë më shumë

1. Cili numër do të fitohet, nëse nga numri më i madh dyshifror zbresim numrin më të madh të dhjetëshes së parë:

- a) 78 b) 80 c) 81 ç) 89

2. Në çdo kënd të dhomës është vendosur nga 1 karrike. Në çdo karrike rri ulur nga 1 vajzë. Sa vajza gjenden në dhomë, po qe se secila, sheh 3 vajza?

- a) 3 b) 4 c) 6 ç) 8

3. Secili nga 3 shokët në shëtitje, hëngri nga 3 akullore. Sa euro ata harxhuan atë ditë nëse një akullore kushtonte 30 cent?

- a) 2€ e 20 cent b) 3€ e 40 cent c) 2€ 70 cent ç) 4€

4. Tomorri kishte 2€ 80 cent. Atë ditë ai bleu 6 fletore nga 40 cent. Sa para i mbetën Tomorrit?

- a) 40 cent b) 60 cent c) 2€ ç) 20 cent

5. Blerta në vitrinën e saj ka 3 bluza dhe 4 funde. Sa herë mund të dalë Blerta në qytet dhe çdo herë të jetë e veshur ndryshe?

- a) e herë b) 8 herë c) 10 herë ç) 12 herë

6. Loja e volejbollit zgjat 2 orë e 45 minuta. Sa minuta janë gjithsej?

- a) 120 min b) 134 min c) 144 min ç) 154 min

7. Në çantën e Aidës kishte 3 herë më shumë libra se në çantën e Artinës. Sa libra janë në çantën e Artinës, nëse në të dyja çantat janë 16 libra?

- a) 14 libra b) 12 libra c) 8 libra ç) 4 libra

8. Dje shiu filloi të bjerë në orën 16 pasdite dhe ra pa ndërprerë deri sot në orën 10 paradite. Sa orë ka rënë shi pa ndërprerë?

- a) 14h b) 16h c) 18h ç) 20h

9. Sa është shuma e të gjithë numrave të orës së murit

- a) 24 b) 57 c) 78 ç) 68




10. Sa është shuma e shifrave të orës së murit?

- a) 87 b) 57 c) 42 ç) 51

11. Sa trekëndësha shihni në figurë?

- a) 3 b) 4 c) 5 ç) 6



12. Jonida në mëngjes mori nga nëna e saj 40 cent, kurse nga babai 20 cent. Për 30 cent ajo bleu akullore. Tani Jonidës i mbetën 80 cent. Sa cent Jonida kishte mbrëmë?

- a) 20 cent b) 30 cent ç) 40 cent d) 50 cent

13. Në ditëlindjen e Sokolit erdhën 5 shoqe që janë 2 më pak se shokët dhe për 1 më shumë se motra që ka ai. Sa mysafirë ishin gjithsej në ditëlindjen e Sokolit?

- a) 12 b) 14 c) 16 ç) 18

14. Gjyshi dhe nipi vendosën që ujin e mbushur nëpër enë ta filtrojnë. Gjyshi kishte 2 enë me nga 15 litra, kurse nipi 2 enë me nga gjysmë litri. Makina për filtrim për 1 sekondë filtron 2l ujë. Sa sekonda nevojiten për ta filtruar ujin, nëse gjyshi dhe nipi kanë mbajtur 2 herë ujë ?

- a) 30 sekonda b) 31 sekonda c) 32 sekonda ç) 33 sekonda

15. Gjatë një pushimi 1-javor, Jeta për mëngjes dhe drekë ha nga 1 mollë, ndërsa për darkë ajo ha 2 mollë. Sa mollë i ka ngrënë Jeta gjatë pushimit 1-javor?

- a) 20 mollë b) 25 mollë c) 28 mollë ç) 30 mollë

16. Në kuzhinën e Lisit janë 4 karrike dhe 1 tavolinë. Secila pjesë e mobiljeve ka nga 4 këmbë. Sa këmbë janë në kuzhinën e Lisit, nëse për mëngjes janë ulur Lisi, nëna dhe babai i tij?

- a) 14 b) 16 c) 18 ç) 26

17. Nga 3 kilogramë mollë fitohen 1 kg marmelatë. Sa kilogramë mollë nevojiten për të fituar 16 kg marmelatë?

- a) 48 b) 36 c) 28 ç) 40 kg

18. Në librin e Lirimit mungojnë fletë, të cilat janë të shënuara prej 7 deri 20. Sa fletë të librit mungojnë?

- a) 6 b) 7 c) 8 ç) 10

19. Në një rrugë e cila ka 60 shtëpi, janë vendosur tabelat me numra të shtëpisë. Sa shifra janë shkruar gjithsej në ato tabela?

- a) 91 shifra b) 54 shifra c) 84 shifra ç) 111 shifra

20. Nëse i shkruan me radhë numrat e qindëshes së parë, sa herë është shkruar shifra 0?

- a) 21 b) 18 c) 20 ç) 25

21. Sa herë do ta përdorim shifrën 1, nëse i shkruajmë të gjithë numrat e qindëshes së parë?

- a) 18 b) 20 c) 21 ç) 25

22. Nëse i shkruan të gjithë numrat e qindëshes së parë, sa herë do të shkruhet shifra 7?

- a) 15 b) 11 c) 20 ç) 25

23. Në 2 salla të një hoteli gjenden 82 mysafirë. Nëse nga salla e parë dalin 30 njerëz dhe nga salla e dytë 40 njerëz, atëherë në secilën sallë do të mbetet numër i njëjtë i mysafirëve. Nga sa mysafirë ka pasur në secilën sallë në fillim?

- a) 50 dhe 32 b) 33 dhe 49 c) 35 dhe 49 ç) 36 dhe 46

24. Në ditën e parë Dioni e lexoi gjysmën e faqeve të librit, kurse ditën e dytë lexoi gjysmën e faqeve të mbetura. Cilat pjesë të faqeve të librit kanë mbetur të palexuara?

- a) $1/2$ e faqeve b) $1/3$ e faqeve c) $1/5$ e faqeve ç) $1/4$ e faqeve

25. Para nesh gjendet një kuti e mbushur me bonbone. Gjysma e tyre janë të kuqe, çereku i tyre janë ngjyrë kafe, kurse 12 bonbonet e mbetura janë të verdha. Sa bonbone ishin në kuti?

- a) 36 b) 48 c) 40 ç) 54

26. Gjysma e gjysmës së një numri është 9. Cili është ai numër?

- a) 32 b) 36 c) 42 ç) 48

27. Mbi tortën e ditëlindjes së Lorikut ishin të vendosur 8 qirinj. Një qiri digjet për 9 minuta. Nëse të gjithë qirinjtë ndizen njëkohësisht për sa minuta do të digjen 8 qirinjtë?

- a) 9 minuta b) 18 minuta c) 72 minuta ç) 24 minuta

28. Gjatësia dhe gjërësia e një drejtkëndëshi së bashku është 28 cm. Gjatësia e tij është 16 cm. Për sa centimetra gjerësia është më e vogël se gjatësia?

- a) 6 cm b) 4 cm c) 8 cm ç) 3 cm

29. Brinja e katrorit është e barabartë me gjatësinë e drejtkëndëshit. Për sa cm perimetri i katrorit është më i madh se perimetri i drejtkëndëshit, nëse gjerësia e drejtkëndëshit është 4 cm dhe është për 3cm më e vogël se gjatësia.

- a) 3 cm b) 6 cm c) 9 cm ç) 10 cm

30. Nga drejtkëndëshi me brinjë 10 cm dhe 8 cm është hequr katrori me brinjë 8 cm. Sa është perimetri i figurës së mbetur?

- a) 10 cm b) 16 cm c) 20 cm ç) 24 cm

31. Nga numri më i madh dyshifror i shkruar me shifra të ndryshme, zbritet numrin dyshifror më të vogël të shkruar me shifra të njëjta. Cilin numër do ta fitosh?

- a) 77 b) 87 c) 78 ç) 68

32. Cili numër do të fitohet, nëse nga numri më i madh dyshifror zbritet numri më i vogël i dhjetëshes së katërt?

- a) 48 b) 58 c) 68 ç) 78

33. Sa do të jetë i zbritshmi në këtë njehsim të jashtëzakonshëm $###-##=1$?

- a) 98 b) 100 c) 99 ç) 101

34. Vlera e x në barazimin e dhënë $213 = x - 121$ është:

- a) $x = 434$ b) $x = 234$ c) $x = 314$ ç) 334

35. Vlera e x në barazimin e dhënë $308 = 345 - x$ është:

- a) 173 b) 137 c) 37 ç) 57

36. Vlera e x në barazimin e dhënë $426 - x = 111$ është:

- a) 315 b) 215 c) 115 d) $x = 415$

37. Sa numra të ndryshëm më të vegjël se 1000 mund të shkruhen vetëm me anë të shifrës 5?

- a) 2 numra b) 3 numra c) 10 numra ç) 8 numra

38. Anëtar i ardhshëm i vargut të numrave 1, 5, 9, 13, 17, ... që kanë lidhje logjike është:

- a) 19 b) 24 c) 21 ç) 25

39. Tri mollë dhe një dardhë kanë masën 680 gramë. Kurse një mollë dhe një dardhë kanë masën 360 gramë. Sa gramë peshojnë 2 mollë?

- a) 320 g b) 220 g c) 300 g ç) 180 g

40. Lirimi ka 90 cent, Tomori ka 10 cent më pak se Lirimi, kurse Dioni ka 10 cent më shumë se Lirimi. Ata vendosën të blejnë së bashku një çokolatë e cila kushton 270 cent. Sa cent atyre u mungojnë?

- a) 20 cent b) 30 cent c) 10 cent ç) 25 cent

41. Toni ka 5 euro. 1 euro ia dha motrës. Atëherë ata kishin numrin e njëjtë të eurove. Sa euro motra e Tonit kishte në fillim?

- a) 3 euro b) 4 euro c) 5 euro d) 1 euro

42. Dy enë të mbushura me domate peshojnë 78 kg. Secila enë e zbrazët peshon 6 kg. Sa kg domate janë në dy enët?

- a) 64 kg b) 66 kg c) 76 kg ç) 56 kg

43. Një tullë e gjysmë peshon 6 kg. Sa do të peshojnë 4 tulla?

- a) 16 kg b) 12 kg c) 8 kg ç) 10 kg

44. Në mes dy fidanëve që janë në largësi 25 metra njëri prej tjetrit, duhet të mbillen fidanë të rinj në distancë prej 5 metrave. Sa fidanë të tillë mund të mbillen?

- a) 3 fidanë b) 5 fidanë c) 4 fidanë ç) 10 fidanë

45. Në një kuti gjenden 10 sfera të kuqe dhe 4 sfera të bardha. Sa sfera më së paku duhet të nxirren symbyllazi nga kutia që të jemi të sigurt se kemi nxjerrë një sferë të kuqe?

- a) 2 sfera b) 3 sfera c) 6 sfera d) 5 sfera

46. Dy punëtorë punuan gjithsej 11 orë. Punëtori i parë punoi 3 orë më shumë se i dyti. Gjatë asaj kohe ata i prodhuan 22 detaje. Sa detaje prodhoi punëtori i dytë?

- a) 8 detaje b) 15 detaje c) 14 detaje ç) 16 detaje

47. Dioni është 7 herë më i ri se gjyshi i tij, kurse gjyshi i tij edhe 9 vjet i mbush 100 vjet. Sa vjet i ka Dioni?

- a) 13 vjet b) 14 vjet c) 15 vjet ç) 17 vjet

48. Nëse pyetja është: "Sa vjet i ka gjyshi?" ndërsa përgjigjja është: "Po t'i kisha edhe gjysmën e viteve që kam sot dhe 4 vjet, atëherë do t'i kisha 100 vjet.", sa vjet i ka gjyshi në të vërtetë?

- a) 100 vjet b) 64 vjet c) 83 vjet ç) 73 vjet

49. Nipi i ka 13 vjet. Pas 7 vjetëve, ai do të jetë 4 herë më i ri se gjyshi. Sa vjet i ka gjyshi?

- a) 73 vjet b) 80 vjet c) 68 vjet ç) 82 vjet

50. Nëna e Ersenit i ka 42 vjet. Para 3 vjetëve, ajo ishte 3 herë më e vjetër se Erseni. Sa vjet i ka Erseni?

- a) 15 vjet b) 13 vjet c) 17 vjet ç) 16 vjet

51. Në qindëshen e parë ekziston një numër i çuditshëm. Ai numër shkruhet me shifra të njëjta, por gjithashtu edhe gjysma e tij, çereku si dhe e teta pjesë e atij numri shkruhen me shifra të njëjta. Cili është ai numër?

- a) 66 b) 88 c) 77 ç) 99

52. Numri më i vogël dyshifror është më i vogël se numri më i madh dyshifror për:

- a) 66 b) 89 c) 90 ç) 88

53. Cili numër është për 36 më i madh se çereku i tij?

- a) 48 b) 52 c) 64 ç) 44

54. Shuma e gjysmës dhe çerekut të një numri është 72. Cili është ai numër?

- a) 86 b) 76 c) 96 ç) 106

55. Vëllai dhe motra së bashku kanë 104 euro. Këto të holla duhet t'i ndajnë, por vëllai duhet të marrë 16 euro më shumë se motra. Sa euro i takojnë vëllait?

- a) 72 euro b) 48 euro c) 60 euro ç) 56 euro

56. Dy shokë, kanë së bashku 120 fotografi. Nëse njëri i jep tjetrit 18 fotografi, atëherë ata do të kenë numër të njëjtë të fotografive. Nga sa fotografi ka secili?

- a) 78 me 42 b) 76 me 44 c) 70 dhe 50 ç) 80 me 40

57. Blendi ka 6 herë më shumë euro se Lisi. Nga sa euro ka secili prej tyre, nëse së bashku kanë 84 euro?

- a) 72 me 12 b) 70 me 14 c) 68 me 16 ç) 74 me 10

58. Në dy kuti gjenden 315 fletore. Nga sa fletore ka në secilën kuti, nëse në njërin kuti ka 4 herë më shumë se në kutinë tjetër?

- a) 254 me 61 b) 230 me 85 c) 252 me 63 ç) 241 me 74

59. Babai dhe djali kanë së bashku 60 vjet. Para 5 vjetëve babai ishte 4 herë më i vjetër se djali. Nga sa vjet kanë sot, babai dhe djali?

- a) b=45 vjet d=15 vjet b) b=40 vjet d=20 vjet
c) b=42 vjet d=18 vjet ç) b=46 vjet d=14 vjet

60. Cili numër është për 120 më i madh se $\frac{1}{3}$ e tij ?

- a) 200 b) 160 c) 180 ç) 150

61. Për librin është paguar 10 € dhe $\frac{1}{3}$ e çmimit të librit. Sa është çmimi i librit?

- a) 20 € b) 18 € c) 15 € ç) 12 €

62. Tri vajza i kanë së bashku 50 kukulla. Vajza e parë ka 4 herë më pak kukulla se vajza e dytë, kurse vajza e tretë ka 5 herë më shumë se vajza e parë. Nga sa kukulla ka secila?

- a) 5, 20 dhe 18 b) 5, 20 dhe 25 c) 8, 12 dhe 30 ç) 18, 12 dhe 20

63. Secili nga tre shokët hëngrën nga tre akullore. Sa denarë janë harxhuar atë ditë, nëse çmimi i një akulloreje ka qenë 30 denarë?

- a) 120 denarë b) 270 denarë c) 360 denarë ç) 150 denarë

64. Blerta, në vitrinën e saj kishte 3 bluza dhe 4 funde. Në sa mënyra të ndryshme mund të vishet Blerta?

- a) 2 b) 6 c) 12 ç) 9

65. Loja e volejbollit zgjat gjithsej 2 orë e 24 min. Sa minuta gjithsej ka zgjatur loja e volejbollit?

- a) 120 minuta b) 144 minuta c) 150 minuta ç) 224 minuta

66. Tomori kishte 280 denarë. Ai bleu 6 fletore me çmim nga 40 denarë. Sa denarë i kanë mbetur Tomorit?

- a) 20 denarë b) 30 denarë c) 40 denarë ç) 50 denarë


67. Në çantën e Aidës kishte 3 herë më shumë libra se në çantën e Artinës. Sa libra ka në çantën e Artinës nëse të dyja çantat kanë gjithsej 16 libra?

- a) 12 libra b) 20 libra c) 18 libra ç) 16 libra

68. Të shkruhen të gjithë numrat treshifrorë shuma e shifrave të të cilëve është 10 dhe nëse shifra e qindësheve është më e madhe se shifra e dhjetësheve si dhe shifra e dhjetësheve është më e madhe se shifra e njësheve.

69. Përcakto rregullën dhe vazhdo vargun për tre kufiza tjera nëse: 1, 2, 3, 5, 8, 13,...

70. Vizato figurën në fletore, vendos numrat dhe operacionet përkatëse në fushat e parashikuara ashtu që rezultatet të jenë të sakta:



71. Të shkruhen të gjithë numrat më të vegjël se 100 që shkruhen vetëm me dy numra romakë.

72. Shuma e viteve të një grupi të nxënësve është 56. Pas 2 vjetësh, shuma e viteve të tyre do të jetë 70. Sa nxënës janë gjithsej në atë grup?

73. Lisi 12 minuta pasi ka filluar filmi e ka shikuar orën. Ora ka qenë 20 e 27 minuta. Nëse filmi ka zgjatur 90 minuta, në çfarë ore ka përfunduar filmi?

74. Topi rrokulliset tatëpjetë. Në sekondën e parë kalon 3 metra, në sekondën e dytë kalon 4 metra, në sekondën e tretë i kalon 5 metra. Sa metra do të kalojë topi për 10 sekonda?

75. Të plotësohet tabela:

+			
	467	546	
500	650		826
208			

76. Prodhimi i shifrave të numrit 127 është $1 \cdot 2 \cdot 7 = 14$. Të shkruhen të gjithë numrat treshifrorë çift, prodhimi i shifrave të të cilëve është 12.

77. Të shkruhen të gjithë numrat treshifrorë që shkruhen me ndihmën e shifrave 5,3,8 (shifrat mund të përsëriten) dhe që janë më të mëdhenj se 555.

78. Njehso numrin që është për 45568 më i madh se numri 109109.

79. Zëvendëso shkronjat me shifra ashtu që rezultati të jetë i saktë, nëse numri *MM* është numër nga dhjetëshja e katërt.

$$\begin{array}{r} M M \\ + L L \\ \hline D M C \end{array}$$

80. Nga numri më i madh treshifror, të zbritet shuma e numrit më të madh tek të qindëshes së tretë dhe numrit më të vogël çift të qindëshes së pestë.

81. Nga numri më i madh treshifror, të zbritet shuma e numrit më të madh çift të qindëshes së tretë dhe numrit më të vogël tek të qindëshes së pestë.

82. Fisi është nisur në rrugë të gjatë prej 730 km, të cilën dëshiron ta kalojë për tre ditë. Ditën e parë ai ka kaluar 240 km, ditën e dytë 120 km më tepër se ditën e parë. Sa kilometra rrugë i kanë mbetur Fisit për ta kaluar ditën e tretë?

83. Rradhiti sipas madhësisë numrat romakë duke filluar nga numri më i vogël: CVIII, DCCXXXIV, CMXLVII, LX, XL, XIX, D, CXII, CDXV.

84. Të shkruhen të gjithë numrat tek të qindëshes së tetë shuma e shifrave të të cilëve është 19.

85. Çmimi i biletës për hyrje në kopshtin zoologjik për persona të rritur është 4\$, ndërsa për fëmijë 1 \$ më pak. Sa duhet të paguajë babai për të hyrë në kopshtin zoologjik me 2 fëmijët e tij?

- a) 5\$ b) 6\$ c) 7\$ ç) 10\$ d) 12\$

86. Dita ka 37 bonbone. Shoqja e saj Hana i ka thënë: “Nëse më jep 10 bonbone, do të kemi numër të njëjtë të bonboneve”. Sa bonbone ka pasur Hana?

- a) 10 bonbone b) 17 bobone c) 22 bonbone ç) 32 bonbone

87. Yllka ka vizatuar në brendinë e drejtëkëndëshit një pikë. Nëpër këtë pikë ajo ka tërhequr 4 drejtëza. Në sa pjesë do të ndahet drejtëkëndëshi?

- a) 4 b) 6 c) 8 ç) 10 d) 12

88. Sa dhoma 2-krevatëshe duhet t’i shtohen grupit të 5 dhomave trekrevetëshe të hotelit, që të akomodohen 21 mysafirë?

- a) 1 b) 2 c) 3 ç) 5 d) 6

89. Në disk janë incizuar 3 këngë. E para ka zgjatur 6 minuta e 25 sekonda, e dyta 12 minuta e 25 sekonda dhe e treta 10 minuta dhe 13 sekonda. Sa zgjasin 3 këngët së bashku?

- a) 28 minuta e 30 sekonda b) 29 minuta e 3 sekonda c) 30 minuta e 10 sekonda
ç) 31 minuta e 13 sekonda d) 31 minuta e 23 sekonda

90. Kanguri ka vërejtur që çdo dimër e shton peshën për 5 kg, kurse çdo verë humb nga pesha 4 kg. Sa kilogramë ka pasur kanguri në vitin 2004, nëse në vitin 2008 ka pasur 100 kg?

- a) 92 kg b) 93 kg c) 94 kg ç) 96 kg d) 98 kg

91. Kopshti është në formën e katrorit dhe përbëhet prej pishinës (P), lulishtes (L), pjesës me kullosë (K) dhe pjesës me rërë (R) (shiko vizatimin). Perimetri i pjesës me kullosë është 20 m, kurse perimetri i lulishtes është 12 m. Sa është perimetri i lulishtes dhe pishinës?

P	L
K	R

- a) 10 m b) 12 m c) 14 m ç) 16 m d) 18 m

92. Lumi ka aq vëllezër sa edhe motra. Motra e tij Dita ka dyfish më shumë vëllezër se motra. Sa fëmijë ka në atë familje?

- a) 3 b) 4 c) 5 ç) 6 d) 7

93. Në një kuti gjinden 7 letra ku janë shënuar numrat prej 1 gjer në 7. Me zgjedhje të rastësishme nga kutia, nxënësi i parë tërheq 3 letra, ndërsa nxënësi i dytë tërheq 2 letra. Në kuti mbetin 2 letra. Nxënësi i parë i thotë nxënësit të dytë: “E di që shuma e numrave të letrave të tua është numër çift”. Sa është shuma e shifrave të letrave të nxënësit të parë?

- a) 10 b) 12 c) 6 ç) 9 d) 15

94. Zgjidhe secilën prej enigmave. Pastaj shkruaje numrin:

a)	Kam 24 dhjetëshe. Më mungojnë 11 për të qenë 251.	
b)	Kam pothuajse 60 dhjetëshe, por më mungojnë 9.	
c)	Nëse më japin 7 dhjetëshe, do të kem 400.	
ç)	Më duhen 10 dhjetëshe për të qenë 999.	
dh)	Kam 1 dhjetëshe më shumë se 510.	

95. Një familje ka porositur 2 pica. Çdo picë ka qenë e prerë në 8 pjesë. Ata kanë ngrënë 15 copë. Sa pjesë të picës kanë mbetur pa ngrënë?

96. Arti ka mbledhur domate nga kopshti. Kur e ka prerë secilën në 4 pjesë të barabarta, ai ka fituar 12 pjesë. Sa domate ka mbledhur ai?


97. Katër mysafirë në një restorant kanë marrë 5 bukëza, që i kanë ndarë në mënyrë të barabartë. Nga sa bukëza ka marrë secili prej tyre?

98. Në një argëtim janë ndarë 3 torta. Aty ka pasur 15 mysafirë dhe secili ka marrë copë me madhësi të njëjtë. Në sa pjesë të barabarta është ndarë torta?

99. Katër shkopinj kishin gjithsej 8 skaje. Sa skaje kane gjashtë shkopinj e gjysmë?

- a) 6 b) 8 c) 12 d) 13 dh) 14

100. Drini nga 10 pllaka me gjerësi 4 cm dhe gjatësi 6 cm në oborr ka formuar shtegun si në figurë. Ai ka bashkuar meset e pllakave dhe ka formuar vijën. Sa është gjatësia e vijës?



- a) 24 cm b) 40 cm c) 46 cm d) 50 cm dh) 66 cm

101. Driloni e ka hedhur zarin 4 herë. Numri i pikëve në faqen e sipërme, gjithsej ka qenë 23. Sa herë i ka rënë numri 6 në faqen e sipërme?

- a) 0 b) 1 c) 2 ç) 3 d) 4 dh) 5

102. Grupi i vallëzimit përbëhet prej 25 djemve dhe 19 vajzave. Çdo javë grupit i bashkohen nga 2 djem dhe 3 vajza. Pas sa javëve, numri i djemve dhe vajzave barazohet?

- a) 6 b) 5 c) 4 d) 3 dh) 2

103. Fisi e ka ndarë çokollatën në pjesë me 5 katrorë të cilët ia ka dhënë vëllait, ndërsa motrës i ka dhënë pjesë me 7 katrorë si në figurë. Sa pjesë ka pasur çokollata?

- a) 22 b) 28 c) 32 d) 35 dh) 40 e) 54

Vëllai	
M	
o	
t	
r	
a	

104. Blendi ka 6 herë më shumë denarë se Lisi. Ata së bashku kanë 84 denarë. Nga sa denarë ka secili prej tyre?

105. Vëllai dhe motra së bashku kanë 104 \$. Këto të holla duhet të ndahen në atë mënyrë që vëllai të marrë 16\$ më shumë se e motra. Sa \$ do të marrë vëllai?

106. Shuma e gjysmës dhe çerekut të një numri është 72. Cili është ai numër?

107. Sa herë numri më i vogël dyshifror që shkruhet me shifra të njëjta, është më i vogël se numri më i madh dyshifror?

108. Lea ka pasur 37 disqe. Shoqja e saj Dea i ka thënë: “Nëse m’i jep 10 disqe, atëherë do të kemi numër të njëjtë disqesh”. Sa disqe ka pasur Dea?

- a) 10 b) 17 c) 22 ç) 27 d) 32

109. Rita ka vizatuar një pikë në fletën e fletores dhe ka tërhequr 4 drejtëza që kalojnë nëpër atë pikë. Në sa pjesë të barabarta është ndarë fleta e fletores?

110. Arbi shumëzon me 3, Burimi shton 2, ndërsa Drini zbret numrin 1. Me çfarë renditjeje duhet të kryhen operacionet që nga numri 3 të fitohet numri 14?

- a) Arbi, Burimi, Drini b) Burimi, Arbi, Drini c) Arbi, Drini, Burimi
ç) Drini, Arbi, Burimi d) Burimi, Drini, Arbi dh) Drini, Burimi, Arbi

111. Peshorja është në drejtpeshim. Sa kg është shalqiri?

- a) 4 kg b) 5 kg c) 6 kg ç) 8 kg



112. Sa kilogramë peshon secili thes?

- a) 5 kg b) 6 kg c) 7 kg ç) 8 kg



113. Caktoni sa peshon një paket nëse:

- a) 2 kg b) 3 kg c) 4 kg ç) 6 kg



114. Shuma e viteve të babait, nënës, vajzës dhe djalit është 98 vjet. Djali ka 8 vjet, vajza është 3 vjet më e vjetër së vëllai, kurse nëna 3 herë më e vjetër se vajza. Sa vjet ka babai?

115. Shkruani numrin i cili ka 11 njëshe, 11 dhjetëshe dhe 11 qindëshe.

116. Sa numra treshifrorë mund të shkruhen me shifrat 4, 5, 6 dhe cilët janë ata, nëse secila shifër përdoret vetëm një herë?

117. Ndërmjet pesësheve vendosni shenjat "+", "-", "·", ":", ashtu që të vlejë $5\ 5\ 5\ 5\ 5=5$.

118. Shkruani gjithë numrat e qindëshes së pestë, në të cilët shifra e njësheve është për dy herë më e madhe se shifra e dhjetësheve.

119. Shkruani gjithë numrat e qindëshes së pestë në të cilët shifra e dhjetësheve është për 1 më e madhe se shifra e qindësheve.

120. Perimetri i trekëndëshit është 75 cm, kurse dy brinjët e tij janë 24 cm dhe 26 cm. Sa cm është brinja tjetër?

121. Në një fabrikë ka 864 të punësuar. Numri i femrave është tre herë më i vogël se numri i meshkujve. Sa prej të punësuarve janë meshkuj dhe sa femra?

122. Sa skaje kanë dy shkopinjë të prerë përgjysmë?

123. Sa është ndryshimi i numrit më të madh treshifror tek dhe numrit më të madh dyshifror çift?

124. Një libër ka 150 faqe. Sa shifra janë përdorur për shkrimin e faqeve të tij?

125. Gjatë një rruge të drejtë janë mbjellur 21 drunj në largësi prej 12 metrash njëri nga tjetri. Sa është largësia ndërmjet drurit të parë dhe atij të fundit?

126. Perimetri i një trekëndëshi është $P=69$ cm, kurse brinja më e vogël 18 cm. Sa janë gjatësitë e dy brinjëve tjera, nëse ato janë dy numra të njëpasnjëshëm?

127. Prej vendit A deri te vendi B mund të shkohet nëpër 3 rrugë të ndryshme. Kurse prej vendit B deri te vendi C mund të shkohet nëpër 4 rrugë të ndryshme. Nëpër sa rrugë mund të shkohet prej vendit A deri te vendi C?

128. Prej dy qyteteve të ndryshme u nisën dy automobila përballë njëri-tjetrit. Automobili i parë lëviz me shpejtësi 65 km në orë, kurse automobili i dytë me shpejtësi 75 km në orë. Sa është largësia në mes atyre qyteteve nëse automobilat takohen pasë 4 orë udhëtimi?

129. Në një enë të madhe për ujë Blerta derdhi 8 herë nga 10 litra ujë, kurse më vonë Blerta nxori 6 herë nga 7 litra ujë. Sa litra ujë kanë mbetur në enë?

130. Motoçiklisti prej vendit A për në vendin B kaloi 140 km. Në kthim pasi kaloi $\frac{1}{5}$ e rrugës u ndal për pushim. Sa km i ka kaluar ai?

131. Aeroplani ka zbritur në ora 19 e 40 min. Udhëtimi ka zgjatur 3 orë e 18 minuta. Sa ishte ora kur aeroplani ka filluar udhëtimin ?

132. Nëna dhe babai kanë 3 vajza. Secila motër ka nga 4 vëllezër. Sa anëtarë ka kjo familje?

133. Në një klasë janë 31 nxënës, vajza janë 3 më pak se djem. Sa vajza ka në atë klasë?

134. Lara është 3 vjet më e vjetër se motra e vet Mira. Pas 8 vjetëve, sa vjet do të jetë Lara më e vjetër se Mira?

135. Shuma e dy segmenteve \overline{AB} dhe \overline{BC} është 96 cm. Gjatësia e segmentit \overline{BC} është sa dy segmente të \overline{AB} . Gjeni gjatësitë e dy segmenteve.

136. Të shkruhet numri treshifror ndërmjet numrit 900 dhe 950, ashtu që shifra e njësheve të jetë 1, kurse shifra e dhjetësheve të jetë 3 herë më e madhe se shifra e njësheve.

137. Tregtari prej 900 kg dardha shiti 540 kg. Pjesën tjetër të dardhave e futi në kuti prej 12 kg. Sa kuti iu deshën tregtarit?

138. Cili numër duhet t'i shtohet prodhimit të numrave 143 dhe 3 që të fitohet numri 800?

139. Gjatësia e një segmenti është 128 cm. Segmenti i dytë është për 24 cm më i shkurtër se segmenti i parë, kurse i treti është për 18 cm më i gjatë se i dyti. Sa është shuma e gjatësive të tre segmenteve?

140. Sa shifra janë përdorur për shënimin e librit prej 120 faqeve?

141. Gjysma e gjysmës së një segmenti është 10 cm. Sa është gjatësia e segmentit?

142. Tre shokë para 10 vjetëve, së bashku kishin 10 vjet. Sa vjet kanë ata, së bashku, tani?

143. Shkruani numrin e ardhshëm të vargut 3, 5, 9, 15, 23,....

144. Perimetri i një katrori është 20 cm. Nga dy katrorët, Jonida formoi një drejtkëndësh duke i bashkuar. Sa është perimetri i drejtëkëndëshit të fituar?

145. Shuma e tre numrave të njëpasnjëshëm është 183. Cilët janë ata numra?

146. Shuma e dy numrave është 440. Cilët janë ata numra nëse njëri është 3 herë më i madh se tjetri?

147. Prej dy qyteteve të ndryshme, u nisën dy automobila përballë njëri-tjetrit. Automobili i parë lëviz me shpejtësi 65 km në orë, kurse automobili i dytë me shpejtësi prej 75 km në orë. Sa është largësia në mes atyre qyteteve nëse automobilat takohen pas 4 orë udhëtimi?

148. Në një enë të madhe për ujë, Blerta derdhi 8 herë nga 10 litra ujë, kurse më vonë Blerta nxori 6 herë nga 7 litra ujë. Sa litra ujë kanë mbetur në enën e madhe?

149. Motoçiklisti prej vendit A për në vendin B kaloi 140 km. Në kthim pasi kaloi $\frac{1}{5}$ e rrugës, u ndal për pushim. Sa km i ka kaluar ai?

150. Nëna dhe babai kanë 3 vajza. Secila motër ka nga 4 vëllezër. Sa anëtarë ka kjo familje?





151. Në një klasë ka 31 nxënës, vajza janë 3 më pak se djem. Sa vajza ka në atë klasë?

152. Tre shokë para 10 vjetëve së bashku kishin 15 vjet. Sa vjet kanë ata, tani së bashku?


153. Shuma e viteve të babait dhe djalit është 50. Nga sa vjet i kanë babai dhe djali, nëse babai është 28 vjet më i vjetër se djali?


ZGJIDHJET

Zgjidhje pjesa e I

1. a) 18, b) 47, c) 29, d) 39. 2. 101, 97, 95, 91, 85, 83, 79, 77, 75, 71, 69, 65, 61, 57, 55.
3. 13, 25, 31, 43. 4. 20, 25, 30, 35, 40, 45, 50, 55, 60, 65, 70, 75, 80, 85, 90, 95, 100.
5. 20, 25, 30, 35, 40,.... 6. 77. 7. 23. 8. Do të duhen 5 . 9. Ylli duhet të blejë gjithsejt 15 paketa. 10. a) 12; b) 15. 27. 20 . 28. 12 SMS; 29. Shqipja i vendosi 15  30. Dijsa ka pranuar 17  31.

Zgjidhje pjesa e II

1. formoni modelet për zgjidhje nxënësi ti caktojë zgjidhjet.
2. formoni modelet për zgjidhje nxënësi ti caktojë zgjidhjet.
3. d). 4. b). 5. b). 6. ç). 7. 30 herë.
8. Të numërohen katrorët e plotë dhe të kombinohen gjysmat katrorëve.
9. 6 kuti- 5kuti nga 12 vezë dhe 1 kuti me 6 vezë.
10. 11 nxënës.
11. $80=10 \times 5 + 3 \times 10$, $125=12 \times 10 + 1 \times 5$, $115=10 \times 10 + 3 \times 5$, $70=12 \times 5 + 10$, vetëm 60denarë nuk mund të shprehet me monedhat e dhëna.
12. D.
13. 2 ëmbëlsira të ndara në 4 pjesë gjithsejt janë 8 pjesë që janë ndarë edhe në 3 pjesë të barabarta bëjnë 24 copë. Në fund të festës kanë mbetur 3 copë që d.m.th në festë kanë qenë present 21 persona.
14. b) . 15. 698, 689, 986, 968, 896, 869, 998, 989, 899, 866, 686, 668. 16. 64 kube.



17. 8 3 2 18. ç). 19. 54 këmbë. 20. 4.

21. Doni ka pasur hapat më të gjatë. 22. 209.

23. ç) numrin e sekondave për një javë. 24. Lira tani është 13vjeçe. Para 2 vitesh ajo ka qenë 11vjeçe, kurse Dora 4 vjeçe. Dora tani është 6 vjeçe. Dora pas 3 vitesh do të jetë 9 vjeçe.

25. ç)

			69
	72		

26. Shuma e numrave është 20. 27. a) 5. 28. ç)



29. ç)

	A	B	C	D
1				
2				
3				
4				



30. ç) 31. a) 3 fëmijë. 32. Numëro pikët dhe krahaso.

33. b) 8 pllaka. 34. 3 format e fundit. 35. = +12den, = 6den.

36. a) $2 \cdot 10 + 10 = 30$, c) $2 \cdot 8 + 8 = 24$.

37. ç) . 38. ç) 12 kërcime $10 \cdot 3 - 2 \cdot 4 = 30 - 8 = 22$ shkallë.

39. ç) $1+5+5+3+3+2+2+?+?+1+1+2=33$, $25+?+?=33$, $?=4$.

40. ç) 1173, $642+531=1173$, numër më madhë treshifrorë fitohet nëse shifra e qindësheve është më e madhe.

41. Nga ora që shënon kohën 12:55:30 vërehet që akrepi i mesëm shënon orën, akrepi i gjatë minutat, ndërsa akrepi i shkurtër sekondat. Sipas kësaj orën 8:11:00

e shënon ora d) .

42. $((\square \cdot \square + 1) \cdot 10 + 3) \cdot 4 = 2012$ 43.

$((\square \cdot \square + 1) \cdot 10 + 3) = 503$


$(\square \cdot \square + 1) \cdot 10 = 500$

$(\square \cdot \square + 1) = 50$

$\square \cdot \square = 49 \Rightarrow \square = 7$

12x12	24x12		
	24x36		
	24x60		
24x84		84x84	84x84

Drejtëkëndëshi i parë $192 \times 84 - (84 \times 84)$, drejtëkëndëshi i dytë $108 \times 84 - (84 \times 84)$, drejtëkëndëshi i tretë $24 \times 84 - (24 \times 24)$, drejtëkëndëshi i katërt $24 \times 60 - (24 \times 24)$, drejtëkëndëshi i pestë $24 \times 36 - (24 \times 24)$, drejtëkëndëshi i gjashtë 24×12 ku fitohen dy katrorë 12×12 .

44. $4\blacksquare + 5\blacksquare = 104$ shifra e mbuluar është 7. 45. d) . 46. Nga një pako buke pregaditen 12 senduiç, ndërsa nga 2 pako e gjysëm do të pregaditen 30 senduiç.

47. Hana ka gabuar. 48. B. 49. $48 = 3 \cdot 10 + 2 \cdot 9$, gjithsejt 5 pako. 50. b) nëse e rrotullojmë do të formojnë drejtëkëndësh.



51. b) $22 : 2 = 11$, $24 : 4 = 6$, $25 : 5 = 5$,. 52. b) $(31 - 7 \cdot 3) \cdot 24 \cdot 60$. 53. c) 5, rradhitën 3-1-4-5-7 (numrat tregojnë numrin rendor të dominove të rradhitura në figure.

54. b) $1011 + 1001 + 1$. 55. a) 1 dhe 4. 56. a). 57. d) 8. 58. c). 59. E fundit. 60. 48. 61. b). 62. 60, 70, 90.

63. c). 64. b) 181. 65. Shuma për lodrat e blera ka qenë 130€. $130\text{€} = 57\text{€} + 73\text{€}$ dmth tramvain dhe karrocën e ka blerë Blerimi.

$\blacktriangle + 4 = 7$
66. 15. 67. $\blacksquare + \blacktriangle = 9$ $3 + 4 = 7$; $6 + 3 = 9$. 68. d). 69. $15 = 3 \cdot 5 \Rightarrow 3 + 5 = 8$. 70. b) 6. 71. a). 72. b) 3 mollë. 73. b) 13. 74. b) pozicioni i 4. 75. ç) E. 76. ç) 8. 77. a). 78. c) 5. 79. c). 80. a) 2 mollë e gjysëm.

81. a) trekëndësh. 82. c) 2 herë më shumë rrathë se trekënësja. 84. c) 11 dhe 4. 86. a) 1, 3, 5. 87. b) 27.

88. ç) 50. 89. $2016 - 201 = 1815$, $1815 + 102 = 1917$. 90. a) 16. 91. a) 16. 92. b) 4. 93. A). 94. d). 95. d). 96. b) $70 = 2 \cdot 25 + 2 \cdot 10$, 4 paketa. 97. ç) $13 + 19 = 32$, i cili nuk plotëpjestohet me 6, numri i ardhshëm që plotëpjestohet me 6 është numri 36. Duhet të paraqiten edhe 4 fëmijë. 98. c). 99. 75 min. 100. ç) 13. 101. a) 3 dhe 2. 102. c) 115m, $340\text{m} - T = T + 110\text{m}$ 103. c) 5, $11 - 9 = 2$, njëri ka ngrënë 2 gurabije, i dyti 3 gurabije. Mbetet që 2 prej tyre kanë ngrënë $9 - 3 = 6$ gurabije. $6 = 1 + 5$. D.M.th më së shumti ka ngrënë 5 gurabije. 104. ç). 105. b) 3 me 5. 106. 6. 107. d) 12, te pika 16 ka bërë 4 këcime të mëdha dhe 8 të vogla. 108. c). 109. ç) 4, 1, 2, 5, 3. 110. c) 5 dhe 8. 111. ç) 36. 112. b) 3. 113. d) 32. 114. a) 8, 11, 26, 29. 115. b) 11. 116. d) 5. 117. d) 90 cm.

118. d). 119. d). 120. c). 121. a). 122. ç) ai që është djegur më pak. 123. c) 5. 124. b) 5 dhe 9 (këndi 120°).

125. 1 dhe 4. 126. a), b), ç), d). 127. c) 4. 128. c) 8 minuta. 129. d). 130. a) 1kg. 131. d). 132. ç) 5, 5 automobila me nga 2 persona dhe 3 automobila me nga 3 persona, $5 \cdot 2 + 3 \cdot 3 = 19$. 133. b) 5. 134. b). 135. ç) Ç. 136. c) C.

137. d). 138. a). 139. a). 140. b) 2. 141. a). 142. Ç). 143. b) 6. 144. d) 6. 145. c) $6 + 5 + 7 = 18$. 146. d) 5. 147. ç).

148. d) 21. 149. b) 3. 150. b) 3 katrorë dhe 3 trapeza. 151. c) 8. 152. ç) Ç). 153. d) D. 154. c) C. 155. Ç. 156. A).

157. ç). 158. d) 11kg. 159. C. 160. c). 161. d) $300\text{gr} = 100\text{gr} + 200\text{gr}$.

162. ç) 110denarë, molla me dardhën kushtojnë 50den, kurse molla me bananen 70 den dhe dardha me bananen 100 den. D.m.th dardha më e shtrenjtë se molla për 40 den. Atëherë nga molla plus dardha 50 den rrjedhë që molla 10 den, dardha 40 den, kurse bananja 60den. Sëbashku 110den.




163. d) 6. 164. d) $83=38+16+3+26$. 165. b) 3. 166. d). 167. ç). 168. a). 169. a) sepse 3 katrorë i ka të pangjyrosura, ndërsa tjerat kanë 3 katrorë e gjysëm të pangjyrosur. 170. d). 171. c) 16. 172. d). 173. ç) 4.





174. b) 7. 175. $1+2+3+4=10$ trekëndëshat, $5+7+8=20$ katrorët, mbetet numri 6 për rrethin.

176. 5 ekipe nga 5 anëtarë që bëjnë 25 dhe 3 ekipe me 6 anëtarë, që bëjnë gjithësejt 43 pjesëmarrës.

177. c). 178. c) 6. 179. b) $13+2=15$. 180. b) 181. d) 26. 182. c) $27+21=48$.


183. ç) $\square + (\square + 6) = 20 \Rightarrow \square = 7, \square + 6 = 13$.

184. c) 5kg,  =6kg,  =6+4, d.m.th topi ngjyrë hiri është 4kg, topi i zi 2kg, atëherë nga  =14, topi i bardhë 5kg.

185. Nga kutia 3 nxiret vetëm , nga kutia 1 mbetet vetëm , kutia 5 mbetet , nga kutia 4 mbetet të nxiret .


187. d) 49. 188. c) kur janë shitur 6 akullore ka pasur 70 €, kur janë shitur 16 akullore ka pasur 120€. Nga kjo 10 akullore më shumë dhe shuma është rritur për 50€, d.m.th 10 akullore kanë kushtuar 50 €, 1 akullore 5€. Nëse nga 70€ zbritet shuma e vlerës së 6 akulloreve fitohet 40 € që është sasia e të hollave që kanë qenë në arkë para fillimit të shitjes. 189. Ç) Ndryshimi i lartësive $48-36=12$ është edhe ndryshimi i lartësive $32-?=12$ ku $?=20$. 190. ç) Në kuti ka pasur 36 ëmbëlsira sepse 36 plotëpjestohet me 2, 3 dhe 4. Kur i shtohet numri 6 fitohet numri 42 që plotëpjestohet me 7.

191. d) 1 dhe 4, $7+2=9$ kg mollë, $5+6+16=27$ kg banane, $27=3*9$.

192. Numri 6 sepse  193. Nga peshorja e 2 , 1 trekëndësh peshon sa 5 katrorë, nëse te peshorja e 1 zëvendësojmë trekëndëshin me katrorë fitojmë që 1 gjashtëkëndësh është me 3 katrorë. Te peshorja e 3, 2 trekëndëshat janë të barabartë me 10 katrorë, ndërsa 3 gjashtëkëndëshat janë me 9 katrorë. Që të bëhen të 2 tasat e barabartë duhet te tasi i majtë të shtojmë 1 katror. 194. a) 28. 195. Brinja e katrorit merret si njësi për matjen e gjatësisë së rrugës që kërkohet. 196. C) 118. 197. b) 7 vizato. 198. b) B.

199. b) 7. 200. Momentalisht Lisi i ka 21 lodra. Që të ketë secila nga 6 kutitë nga 7 lodra, Lisi duhet të ketë 42 lodra. Atij i nevojiten edhe 21 lodra. 201. d) 17,

202. a)



203. b) $9 \cdot 14 = 126$, $131 = 126 + 5$, d.m.th 10 kuti

204. a) $38 + 4 \cdot 3 = 50$ sheqerka gjithsejt. Ata janë 4 fëmijë dhe nëna d.m.th 5. Ata duhet të kenë nga 10 sheqerka (pasiqë 50 sheqeka janë). Meqë fëmijët kanë nga 3 sheqerka, secilit duhet ti jipet edhe 7 sheqerka. Gjithsejt $78 \cdot 4 = 28$ sheqeka.

205. Që fillojnë me 1 ka 1, që fillojnë me 2 ka 2, me 3 ka 3, me 4 ka 4, me 5 ka 5, me qindëshe 6 ka 6, me qindëshe 7 ka 7, me 8 ka 8 dhe me 9 ka 9 numra. Gjithësejt 45 numra.

206. c) 11, sepse faqja horizontale që nuk duket e zarit të sipërm ka 4 pika, 2 faqet horizontale të zarit të poshtëm sëbashku kanë 7 pika, d.m.th shuma 11 pika. 208. 960g, sepse copa që ka peshuar 60 g është $1/16$ pjesë e tortës. Torta është e përbërë prej 16 pjesëve të tilla. Atëherë $16 \cdot 60 = 960$ g. 209. D) 10. 210. C) 19.

211. C) 10. 212. a) $p18.pm3$ sepse 2 orë $= 120$ min, $120:7 = 17,14$ d.m.th e 18 vijon.

213. 09, 19, 29, 39, 49, 59; 6 herë brenda 1 ore. Ka 7 orë d.m.th $7 \cdot 6 = 42$ herë.

214. c) Nga $25 - 17 = 8$, Narta I ka 8 vjet, ndërsa Onida $8 + 1 = 9$ vjet.

215. 7,8,9; 6,8,9; 6,7,8; 6,7,9; 5,7,9; 5,8,9; 216. a)



217. d) 1 me 6, 218. A) 10 ditë.

219. c) pas rrotullimit



220.



?=ç



të rradhitura që mos të ketë ndërprerje


221.  +  = 2 kunguj +  = 15kg, 2 kunguj = 15kg - 9kg = 6kg,

kungulli = 3kg, shalqini = 5kg, pjepri = 4kg zgjidhja 12kg.

222. b) 2 dhe 3. 223. C) 28. 224. d) $9+0+5=14$.

225. $(6+16+8)+(7+12+8)+(10+6+17)=30+27+33=90$. 226. b). 227. a). 228. D). 229. Ç) 76.

230.ç) Ç



231. c) 3 sepse $18-12=6$, $6:2=3$. 232. a) 12.

233. Për të caktuar cili kombinim mund ta plotësojë tabelën me katrorë provojmë cila treshe e ka shumën 10 sepse duhet të plotësohen 10 katrorë, këtë e jep d) 1, 4, 5.

	A	B	C	D	E
1					
2					
3					
4					
5					
6					

234. D). 235. ç) 80 den.

236. B) 12, për katrorin e 1 duhen $4 \cdot 1 = 4$ pllaka, për katrorin 2 duhen $4 \cdot 2 = 8$ pllaka dhe për katrorin 3 duhen $4 \cdot 3 = 12$ pllaka sepse për një të brinjë nevojiten 3 pllaka.

237. Dino mund ti kalojë këto shtigje 1-5-6-7-8 (shuma 32), 1-5-7-3-4-8 (shuma 34), 1-5-6-7-8 (shuma 27), 1-5-6-2-3-4-8 (shuma 29), 1-2-6-7-3-4-8 (shuma 31), 1-2-6-7-8 (shuma 24), 1-2-3-7-8 (shuma 21), 1-2-3-4-8 (shuma 18). 238. Ç) 711. 239. 12 hapa. 240. ç) N, M, Q, P shiko cila fjongo është ndër fjongot tjera.

241. Brinja e katrorit të vogël është sa gjysma e katrorit të mesëm, brinja e katrorit të mesëm është sa 3 brinjë të katrorit të madhë, 420 cm. 242. Ç).

243. 1 dhe 4, sepse shuma totale e kg është 36kg, e cila duhet të përmbajë 4 pjesë të barabarta, 1 me mollë dhe 3 me banane. Shuma e kg nëpër kuti është 36 që zbërthehet $9+27$ dmth 9kg mollë dhe 27kg banane. $9kg=7kg+2kg$ që është zgjidhja 1 dhe 4.

244. Numri 7. Fillojmë nga shuma 3 që është $3=2+1=1+2$, provojmë cila vlenë dhe fitojmë 7.

245. Gjithsejt janë 75 monedha. Ato duhet ndarë 25 në arkën e vogël dhe 50 në të madhen. Ndarja do të jetë 1. $20+5$, 2. $10+15$, 3. 25, d.m.th 3 mënyra.

Zgjidhje pjesa e III


1. $99-10=89$. 2. b) 4 vajza, sepse secila nga këndi i vet sheh 3 fëmijë. 3. c) 2€ 70c sepse $3 \cdot 3 \cdot 30 = 270c = 2€70c$.


4. a) 40c sepse 2€e $80c=280c$, $280c-4 \cdot 40c=280c-160c=120c$. 5. d) 12 herë sepse $4 \cdot 3=12$.

6) c) 144 min sepse $2 \cdot 60+24=120+24=144$ min. 7. D) 4 libra sepse $16:4=4$, 8. C) 18h,

9. 78 sepse $1+2+3+4+5+6+7+8+9+10+11+12=78$. **10.** ç) $1+2+3+4+5+6+7+8+9+1+0+1+1+1+2=51$. **11.** C) 5. **12.** $80c+30c=110c$, $110c-40c-20c=50c$. **13.** $5+(5+2)+(5-1)=5+7+4=16$. **14.** $2 \cdot (2 \cdot 15 + 2 \cdot 0,5) = 62$ l, $62:2=31$ sec. **15.** $7 \cdot (1+1+2) = 7 \cdot 4 = 28$ mollë. **16.** $5 \cdot 4 + 3 \cdot 2 = 20 + 6 = 26$ këmbë, **17.** $16 \cdot 3 = 48$ kg. **18.** 7 fletë, Për shënimin e fletëve që mungojnë $20-6=14$ numra.d.m.th mungojnë 14 faqe ose 7 fletë. **19.** 111 shifra sepse me numra 1 shifrorë janë shënuar 9 shtëpi, ndërsa $60-9=51$ shtëpi janë shënuar me numra 2 shifrorë. Atëherë $9 \cdot 1 + 51 \cdot 2 = 111$ shifra. **20.** Shifra 0 l bashkangjitet numrave 1,2,3,4,5,6,7,8,9,d.m.th 10,20,30,40,50,60,70,80,90,100, 11 zero.

21. 21 herë 1,10,11,12,13,14,15,16,17,18,19,21,31,41,51,61,71,81,91,100. **22.** 7,17, 27, 37, 47, 57, 67,77, 87, 97. **23.** Në secilën sallë kanë mbetur $(82-30-40):2=6$ mysafirë. Në sallën e pare kanë qenë $30+6=36$, në sallën e dytë $40+6=46$.

24.  $\frac{1}{2}$ e faqeve. **25.** Nga figura e zgjidhjes së detyrës 24 rrjedhë që 12 bonbonet janë $\frac{1}{4}$ e gjithë bonboneve në kuti, d.m.th $12 \cdot 4 = 48$ bonbone. **26.** 36. **27.** 9 minuta. **28.** Gjërësia e drejtëkëndëshit është $28-16=12$ cm, ndryshimi është $16\text{cm}-12\text{cm}=4$ cm. **29.** Sipas kushtit të detyrës gjërësia është $b=4$ cm, $a=b+3\text{cm}=7$ cm. Perimetri l katrorit është $P_k=4 \cdot 4=28$ cm, $P_D=2(4+7)=22$ cm, $28\text{cm}-22\text{cm}=6$ cm më l gjatë perimetri l katrorit prej perimetrit të drejtëkëndëshit. **30.** Figura e mbetur është drjtëkëndësh me brinjë 8cm dhe 2 cm. Prandaj perimetri l tij është 20cm. **31.** $98-11=87$. **32.** $99-31=68$. **33.** 100, sepse kemi ndryshimin e numrit tre shifrorë me numër dyshifrorë. **34.** 334, sepse $x=213+121=334$. **35.** 37 sepse $308=345-x$, $x=345-308=37$. **36.** 315. **37.** 5, 55, 555. **38.** Csecili antar l vargut rritet për 4. **39.** 320 gram sepse $680\text{g}-360\text{g}=320\text{g}$ **40.** 20 cent sepse ata sëbashku kishin $90 + (90-10) + (90+10) = 90+80+100 = 270$ cent. Pasi çokolata ishte 290 cent, atëherë $290-270=20$ cent. **41.** Ata kanë tani nga 4 euro. Meqë Toni i dha motrës 1 euro, ajo ka pasur 3 euro para se ti jep Toni. **42.** $78-2 \cdot 6=78-12=66$ kg. **43.** 1 tullë e gjysëm përbëhet prej 3 gjysmave d.m.th $6:3=2$ kg peshon gjzma e tullës, ndërsa 1 tullë peshon $2 \cdot 2\text{kg}=4$ kg. Pra 4 tulla peshojnë $4 \cdot 4\text{kg}=16$ kg.

44.  4 fidane. **45.** Nëse dëshirojmë të nxjerrim nga kutia një sferë të kuqe dhe nuk kemi fat, atëherë në rastet e padëshirueshme mund të ndodhë që 4 sferat e para të qëllohen të bardha. Prandaj sfera e 5-të është e sigurt se do të jetë e kuqe. Prandaj duhet të nxiren sëpaku 5 sfera. **46.** Punëtorët kanë punuar 11 orë dhe kanë prodhuar 22 detaje d.m.th 2 detaje në orë. Punëtori i parë ka punuar 3 orë më shumë, nëse kishin punuar njëjtë do të punonin nga 4 orë. Punëtori l pare ka punuar $4+3=7$ orë dhe ka prodhuar $7 \cdot 2=14$ detaje. **47.** gjyshi l ka $100-9=91$ vjetë, kurse Dioni $91:7=13$ vjetë. **48.** Nga të dhënat e detyrës kuptojmë që viteve të tanishme të gjyshit i shtohen edhe gjysma e atyre viteve si dhe 4 vite dhe fitohen 100 vite. Vitet e tanishme të gjshit janë 2 gjysma dhe 1 gjysëm që i shtohet fitohen 3 gjysma. $3 \cdot \frac{1}{2} + 4 = 100$, vetëm 3 gjysma janë 96, vetëm një gjysëm e viteve të gjyshit është 32 d.m.th gjyshi i ka 64 vjet. **49.** Pas 7 viteve nipi do të ketë $13+7=20$ vjet. Ndërsa gjyshi do të ketë $20 \cdot 4=80$ vjet. Gjyshi tani i ka $80-7=73$ vjet. **50.** Para 3 viteve nëna e Ersenit ka pasur $42-3=39$

vjet. Atëherë Erseni ka pasur $39:3=13$ vjet. Erseni tani i ka $13+3=16$ vjet. **51.** Është numri 88 sepse $88:2=44$, $88:4=22$, $88:8=11$. **52.** $99-10=89$, **53.** $48:4=12$, $48-12=36$.

54. 96 sepse gjysma dhe çereku i një numri janë 3 pjesë të barabarta d.m.th $72:3=24$ e cila paraqet çerekun e numrit. Numri i kërkuar është $24 \cdot 4=96$. **55.** $104-16=88$ euro janë nëse ata marrin sasinë e njëjtë të hollave ku secili duhet të merr 44 euro. Vëllau do ti merr $44+16=60$ euro. **56.** $120:2=60$, njëri ka $60-18=42$, tjetri $60+18=78$. **57.** Ata kanë sëbashku 84 eu, kurse Blendi ka 6 herë më shumë se Lisi, d.m.th 84 përbëhet prej 7 pjesëve të barabarta. $84:7=12$. Blendi ka $6 \cdot 12=72$ euro, Lisi 12 euro. **58.** c) 252 me 63. **59.** Para 5 viteve ata kanë pasur sëbashku 50 vjet, sepse edhe babai edhe djali kanë nga 5 vite më pak. Meqë babai ka qenë 4 herë më i vjetër se djali kemi që 50 paraqet 5 pjesë të barabarta. $50:5=10$ vitet e djalit para 5 vitesh, $4 \cdot 10=40$ vitet e babait para 5 vitesh. Sot djali ka $10+5=15$ vjet, babai $40+5=45$ vjet. **60.** C) 180, $180/3 + 120=180$. **61.** Çmimi i librit është 15 €, sepse libri është paguar me 10€ dhe $1/3$ e çmimit të tij që d.m.th $2/3$ e çmimit janë 10€ d.m.th $1/3$ është 5€ dhe çmimi është 15€. **62.** I+II+III=50, II=4I, III=5I atëherë I+4I+5I=50, 10 I=50, I=5 vajza e I, Vajza e II=20, vajza e III=25. **63.** gjithsejt janë hëngër 9 akullore, ndërsa janë paguar 270 den. **64.** 12 mënyra.

65. 2ore e 24 minuta= 120min+24min=144min. **66.** 280den.-240den.=40den.

67. $3 \cdot \Delta + \Delta = 16$, $4 \cdot \Delta = 16$, $\Delta = 4$. **68.** 910, 820, 730, 721, 640, 631, 541, 532. **69.** Shuma e dy kufizave paraprake është e barabartë me kufizën pasardhëse, 1, 2, 3, 5, 8, 13, 21, 34, 55, 89, ... **70.** 550, +330, -460.

71. II, IV, VI, IX, XI, XV, XX, XL, LX, LI, LV, LX, XC.

72. Ndryshimi i viteve është $70-56=14$, pasiqë secilit nxënës vitet janë rritur për 2 atëherë $14:2=7$. Grupi ka pasur 7 nxënës.

73. Fimi ka filluar në ora 20 e 15 minuta, filmi ka përfunduar më 21 e 45 minuta.

74.

Sekond1	Sekond2	Sekond3	Sekond4	Sekond5	Sekond6	Sekond7	Sekond8	Sekond9	S10
3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

$3+4+5+6+7+8+9+10+11+12=75m$

75.

+	150	229	326
317	467	546	643
500	650	729	826
208	358	437	534

76. $12 = 2 \cdot 2 \cdot 3$, atëherë numrat treshifrorë janë 223, 232, 162, 126, 134, 143, 413, 431.

77. 583, 558, 588, 835, 853, 833, 855, 883, 838, 885, 858, 888,

78. $109109+45568=$.

79. $\begin{matrix} MM \\ + L L \\ \hline D M C \end{matrix}$ Meqë MM i takon dhjetëshes së katërt $MM=33$, atëherë pasiqë fitohet numër treshifrorë L mund të fitojë vlerat 7, 8, 9. Provojmë për 9 dhe arrijmë në përfundim që $C=2$, $D=1$, $33+99=132$.

80. $999-(299+402)=999-701=298$. 81. $999-(299+402)=999-701=298$.

82. $730\text{km}-(240\text{km}+120\text{km}+240\text{km})=730\text{km}-600\text{km}=130\text{km}$ rrugë Fisi do ti kalojë ditën e tretë.

83. XIX, XL, LX, CVIII, CXII, CCXXXIV, CDXV, D, DCCXVI, CMXLVII.

84. Numri 800 nuk e plotëson kushtin, atëherë mbetet që shifra e qindësheve të këtyre numrave duhet të jetë 7, ndësa shuma e shifrave tjera duhet të jetë 12. Numrat që e plotësojnë kërkesën e deyrës janë 739, 757, 775, 793.

85. 10\$. 86. 37 bonbone - 10 bonbone = 27 bonbone, që paraqet numrin e bonboneve të barabarta. Pasiqë Hana ka marrë 10 bonbonet nga Dita, atëherë mbetet që ajo ka pasur 17 bonbone.

87. 8. 88. $5 \cdot 3 + 6 = 21$, duhet të shtohen 3 dhoma 2 krevetëshe.

89. 6 minuta e 25 sekonda + 12 minuta e 25 sekonda + 10 minuta dhe 13 sekonda = 28 minuta e 63 sekonda = 29 minuta e 3 sekonda.

90. 96 kg. 91. $P_k=20\text{m}$, $P_L=12\text{m}$, $a_k=5\text{m}$, $a_L=3\text{m}$, $a_p=5\text{m}$, $b_{P=3m} P_p=16\text{m}$, $a_R=5\text{m}$, $b_R=3\text{m}$, $P_r=16\text{m}$.

P	L
K	R

92. V – numri i djemve, W – numri i vajzave

$V - 1 = W$ sepse barazohet pasiqë Lumi nuk bën pjesë

$2(V - 1) = W$ sepse Dita nuk bën pjesë

pasi të zëvendësohet fitohet numri i vajzave 3, ndërsa numri i djemve 4 do të thotë numri i fëmijëve është 7.

93. Numrat e shënuar nëpër letrat janë numrat 1,2,3,4,5,6,7, ku 4 numra janë tek dhe 3 numra janë çift. Nëse nxënësi I pare ka thënë që shuma e shifrave të nxënësit të dytë është çift, atëherë, nëse nxënësi I pare tërheq tre numra çift atëherë 4 numrat e mbetur do të jenë tek dhe shuma e çdo dy prej tyre do të jetë çift. Ky është ngjarje e sigurt që mund të ndodhë. Prandaj shuma e numrave të nxënësit ë parl do të jetë $2+4+6=12$.

94.

a)	Kam 24 dhjetëshe. Më mungojnë 11 për të qenë 251	$240+11=251$
b)	Kam pothuajse 60 dhjetëshe, por më mungojnë 9.	$600-9=591$
c)	Nëse më japin 7 dhjetëshe, do të kem 400.	$400-70=330$
ç)	Më duhen 10 dhjetëshe për të qenë 999.	$999-100=899$
Dh)	Kam 1 dhjetëshe më shumë se 510	$510+10=520$

95. Pasiqë pica ka qenë e ndarë në 8 pjesë, secila pjesë paraqet të tetën pjesë të picës. Dy picat kanë sëbashku 16 të tetëta. Pasiqë ata kanë ngrënë 15 copë, d.m.th që ata kanë ngrënë $15/8$. Nga kjo fitohet kanë mbetur edhe $1/8$ pjesë e picës.

96. 3 domate. 97. $\frac{5}{4} = 1\frac{1}{4}$. 98. Në 5 pjesë të barabarta, secili ka marrë $1/5$ pjesë të tortes.

99. 14 skaje.

100. 66cm. **101.** 3 herë ka rënë numri 6. **102.** Pas 6 javëve. **103.** 35 copë katrore.

104. $Blendi + Lisi = 84den$ $Blendi = a, Lisi = b$

$$a = 6b \Rightarrow 6b + b = 84den \quad 7b = 84den \quad b = 84 : 7 = 12$$

Lisi ka 12den, kurse Blendi ka $6 \cdot 12den = 72den$

$$\frac{1}{4}N + \frac{1}{2}N = 72, \frac{1}{4}N + \frac{2}{4}N = 72, \frac{3}{4}N = 72, N = 96$$

105. $vellai + motra = 104\$$, $vellai$ ka 16\$ me shumese e motra

$$Vellai = a, motra = b, a = b + 16\$, b + 16\$ + b = 104\$$$

$$2b + 16\$ = 104\$, 2b = 104\$ - 16\$, 2b = 88\$, b = 44\$, a = 44\$ + 16\$ = 60\$$$



106. $\frac{1}{4}N + \frac{1}{2}N = 72, \frac{1}{4}N + \frac{2}{4}N = 72, \frac{3}{4}N = 72, N = 96$

107. $99 - 11 = 88$, numri më I vogël dy shifrorë me shifra të njëjta është për 88 më I vogël se numri më I madhë dyshifrorë.

108. Nëse Lea i ka dhënë Deas 10 disqe, atëherë asaj i mbesin 27 disqe, d.m.th edhe Dea tani ka 27 disqe. Meqë Dea ka huazuar 10 disqe ajo ka pasur 17 disqe.

109.  8 pjesë të bara.

110. $(3 + 2) \cdot 3 - 1 = 14$, shtojmë 2, shumëzojmë me 3 dhe zbresim numrin 1. **111.** 8kg.

112. 6kg. **113.** 2kg **114.** djali 8 vjetë, vajza i ka $8 + 3 = 11$ vjetë, nëna i ka $11 \cdot 3 = 33$ vjetë.

Babai i ka $98 - (8 + 11 + 33) = 98 - 52 = 46$ vjetë.

115. $11 \cdot 1 + 11 \cdot 10 + 11 \cdot 100 = 1100 + 110 + 11 = 1221$

$$11 = 10 + 1 \quad (10 \text{ njëshe} + 1 \text{ njësh}) = 11 \text{ njëshe}$$

$$11 \cdot 10 = 100 + 10 \quad (10 \text{ dhjetëshe} + 1 \text{ dhjetëshe}) = 11 \text{ dhjetëshe}$$

$$11 \cdot 100 = 1000 + 100 \quad (10 \text{ qindëshe} + 1 \text{ qindëshe}) = 11 \text{ qindëshe}$$

$$1000 + 200 + 20 + 1 = 1221$$

116. 456, 465, 546, 564, 645, 654 gjithsejtë 6 numra treshifrorë.

117. $5 + 5 - 5 \cdot 5 : 5 = 5$. **118.** 402, 413, 424, 436, 448. **119.** 450, 451, 452, 453, 454, 455, 456, 457, 458, 459. **120.** $24cm + 26cm + c = 75cm$, $50cm + c = 75cm$, $c = 75cm - 50cm = 25cm$.

121. $M + F = 864$, $3F + F = 864$, $4F = 864$, $F = 864 : 4$, $F = 216$, $M = 3 \cdot 216 = 648$. **122.** 4 skaje.


123. $999 - 98 = 901$.

124. Për 9 faqet e parajanë përdorur 9 shifra. Për 90 faqet me numra dyshifrorë janë përdorur $90 \cdot 2 = 180$ shifra. Kurse faqet me nura treshifrorë janë përdorur $150 - 99 = 51$ shifra dhe për këto faqe $51 \cdot 3 = 153$ shifra. Numri i shifrave të përdorura për këtë libër janë $9 + 180 + 153 = 342$.

125. Gjithësejtë janë $21-1=20$ largesa. Atëherë $20 \cdot 12=240$ metra është largesa ndërmjet drurit të pare dhe të fundit.

126. $69-18=51$. Dy brinjët tjera janë $(51-1):2=25$ cm dhe 26cm

127. Prej vendit A deri te vendi C mund të shkohet në $3 \cdot 4=12$ rrugë të ndryshme.



128. Largesa mes qyteteve është $65 \cdot 4 + 75 \cdot 4=260+300=560$ km.

129. Në enë kanë mbetur $8 \cdot 10-6 \cdot 7=80-42=38$ litra.

130. $1/5$ e 140 është $140:5=28$ km. Motoëiklisti atë ditë ka kaluar (udhëtuar) $140 \text{ km} + 28 \text{ km}=168 \text{ km}$.

131. $19\text{h } 40\text{min} - 3\text{h } 18\text{min}=16\text{h } 22\text{min}$.

132. Kjo familje është 9 anëtarëshe, ku 2 janë prindërit, 3 janë vajza dhe 4 janë djemtë.

133. Vajza janë $(31-3):2=28:2=14$.

134. Lora pas 8 viteve do të jetë 3 vjetë më e vjetër se Mira.

135. $\overline{AB} + \overline{BC} = 96\text{cm}$, $\overline{AB} + 2 \cdot \overline{AB} = 96\text{cm}$, $3 \cdot \overline{AB} = 96\text{cm}$, $\overline{AB} = 96:3 = 32\text{cm}$, $\overline{BC} = 2 \cdot 32\text{cm} = 64\text{cm}$

136. Numri I kërkuar është 931.

137. Pjesa e mbetur e dardhave është $900-540=360 \text{ kg}$, $360\text{kg} :12=30$ kuti.

138. $143 \cdot 3 + W = 800$, $429 + W = 800$, $W = 800 - 429 = 371$

139. Segmenti I dytë është $128\text{cm} - 24\text{cm} = 104\text{cm}$, Segmenti I tretë është $104\text{cm} + 18\text{cm} = 122\text{cm}$. Atëherë shuma e gjatësive të segmentev është $128\text{cm} + 104\text{cm} + 122\text{cm} = 354\text{cm}$.

140. 9 faqet e para janë shënuar me 9 shifra. 90 faqet janë numra dyshifrorë dhe janë shënuar shifrat $90 \cdot 2=180$ shifra. Faqet me tre shifra janë 21, $21 \cdot 3=63$ shifra. Për shënimin e 120 faqeve janë përdorur $9+180+63=252$ shifra.

141. Pasi gjysma e gjymës është 10 cm, atëherë gjysma është $2 \cdot 10\text{cm}=20\text{cm}$. Pra segmenti do të jetë $2 \cdot 20\text{cm}=40\text{cm}$.

142. Prej atëherë kur shokët kanë pasur sëbashku 10 vjetë, kanë kaluar nga 10 vjet për secilin. Pasi I kanë pasur 10, tani ata sëbashku kanë $10\text{vj} + 3 \cdot 10\text{vj}=40\text{vjetë}$.

143. 3, 5, 9, 15, 23, 33, 45, 59,...

144. $20:4=5$ cm njëra brinjë e katrorit figura e fituar është fitohet derjtëkëndësh me brinjë 5 cm dhe 10 cm. Perimetri i tij është

$P=2 \cdot 5\text{cm} + 2 \cdot 10\text{cm}=10\text{cm} + 20\text{cm}=30\text{cm}$.



145. $a+b+c=180$, $b=a+1$, $c=b+1=(a+1)+1=a+2$, atëherë $a+a+1+a+2=180$, $3a+3=180$, $3a=180-3$, $3a=177$, $a=177:3$, $a=59$, $b=60$, $c=61$.

146. $a+b=440$, $b=3\cdot a$, $a+3a=440$, $4a=440$, $a=110$, 330 .

147. Largesa ndërmjet qyteteve është $65\cdot 4 + 75\cdot 4 = 260 + 300 = 560km$.

148. Në enë kanë mbetur $8\cdot 10 - 6\cdot 7 = 80 - 42 = 58litra$.

149. $1/5$ e është $140:5=28km$. Motoçiklisti atë ditë ka kaluar $140km + 28km=168km$.

150. $2+ 4+3=9$ anëtarë ka kjo familje.



151. Vajza janë: $(31-3):2=28:2=14$.



152. Prej atëhere kur shokët kanë pasur sëbashku 10 vjetë, kanë kaluar nga 10 vite për secilin. Pasi I kanë pasur 10 vjet, ata tani sëbashku kanë $10vj + 3\cdot 10vj = 40vj$.

153. Vitet e djalit janë: $(50 - 28) : 2 = 11vjeç$, kurse babai $28+11=39$ vjeç.




FJALORTH


A

Abacus	<p>Është mjet, vegël për numërim, e cila është e formuar me rruaza ose unaza që ndihmojnë për numërim, për llogaritje dhe për të caktuar vlerën e numrave.</p> 
Abshisa	<p>Abshisa e pikës në sistemin koordinativ karteziian është largesa nga boshti y që matet në boshtin x. Është vlera e parë e çiftit të renditur të numrave për atë pikë.</p> 
Aksioma	<p>Pohimi i cili merret i saktë pa vërtetim. Shprehje logjike që konsiderohet e saktë.</p>
Algoritmi	<p>Algoritmi është metoda, rregulla, rruga që duhet ndjekur gjatë llogaritjes ose operacioneve gjatë zgjidhjes së problemeve.</p> $53 \cdot 5 = ?$ $50 \cdot 5 = 250$ $3 \cdot 5 = 15 \qquad 250 + 15 = 265$

Alfa	α Shkronjë greke që përdoret në matematikë, me të shënohen këndet, rrafshet etj.
Algjebra	Algjebra është pjesë e matematikës e cila përdor shkronja dhe simbole për të paraqitur numrat. P.sh.: formula për llogaritjen e syprinës së drejtkëndëshit është $S = a \cdot b$
Am ose a.m	Shkurtesë për <i>ante meridiem</i> - paradite ose mesditë.
Analog	Ora analoge që paraqet kohën me ndihmën e akrepave që lëvizin kontinualisht. 
Aritmetika	Aritmetika është pjesë e matematikës e cila studion vetitë dhe trajtimin e numrave dhe përdorimin e tyre në numërim dhe llogaritje (arithmos ~ numër, nga gjuha greke)
Arkimedi (287 p.e.s – 212 p.e.s)	Matematikani më i njohur i kohës antike. Ai gjithashtu ishte edhe fizikan, inxhinier, astronom. Arkimedi është i pari që ka njehsuar vlerën e π deri në tri decimale. Ai zbuloi njehsimin e vëllimit të piramidës, konit dhe trupave të tjerë.
Ari , 100a=1ha	$\frac{1}{100}$ pjesë e hektarit(ha), simboli për arin është a
Asimetrik	Asimetria është e kundërta e simetrisë; dy gjysma me madhësi ose formë jo saktësisht të njëjtë. Figura që nuk është simetrike është asimetrike. 
Asociativ - ligji asociativ	Ligji asociativ tregon që kur mblidhen ose kur shumëzohen tre ose më shumë numra, rezultati i fituar nuk varet nga mënyra e grupimit të dysheve të atyre numrave. $a+(b+c)=(a+b)+c$, $a \cdot (b \cdot c)=(a \cdot b) \cdot c$.

B

<p>Banknota</p>	<p>Para prej letre.</p>  <p>50 den, 100 den</p>
<p>Bashkësi</p>	<p>Grumbull sendesh, numrash që kanë veti të përbashkët.</p>  <p>P.sh. $A=\{1, 2, 3, 4\}$</p>
<p>Baza</p>	<p>Baza e figurave, trupave gjeometrikë. Zakonisht është pjesa horizontale e tyre, por jo domosdoshmërisht.</p> 
<p>Barabartë</p>	<p>Dy sende, gjëra janë të barabarta nëse janë të barabarta në një mënyrë. Simboli për të barabartën është “=”. P.sh.</p> <p>$3+4=7$</p> <p>$10-3=7$; $3+4$ dhe $10-3$ janë të barabartë sepse së bashku japin rezultatin e njëjtë 7.</p>

Barazi, shenja e barazisë	Shenja, simboli për të barabartën “=” për të treguar sasi të barabartë numrash. Për herë të parë është përdorur nga Robert Recorde në vitin 1557.
Barazim	Barazimi përfaqëson dy shprehje të lidhura me shenjën e barazisë; ose dy pjesë të ndara me shenjën për barazi. Për shembull: $12+x=15$
Binar	I formuar nga dy sende të ndryshme. Sistemi binar i numrave është i formuar nga 1 dhe 0. Baza e sistemit binar numerik është 2.
Binom	Dy terma të lidhur me shenjën “+” ose “-” Për shembull: $2x+5$, $3a-b$,
Busullë	Është pajisje që shërben për orientim në hapësirë. E ndërtuar nga magneti dhe gjilpëra, e cila përdoret si tregues për orientim në hapësirën e rruzullit tokësor. 

C

C C=100 I=1 V=5 X=10 L=50 D=500 M=1000	Romakët e kanë përdorur shkronjën C për të paraqitur numrin 100. 
Celsius	Njësi për matjen e temperaturës. Shkruhet gradë Celsius (°C). Është emëruar sipas shkencëtarit Anton Celsius. Uji ngrin në 0°C , ndësa vlon në 100°C (sipas shkallës Celsius)
Centi	Parashtesë që përdoret për të treguar $\frac{1}{100}$ 1 centimetri është $\frac{1}{100}$ e metrit.
Centilitri (cl) 100cl=1l 1cl=10ml	1 centilitri është $\frac{1}{100}$ pjesë e litrit Centilitri (cl)
Centimetri 100cm=1m	




Cilindër





Trup gjeometrik që ka dy baza në formë të rrethit dhe mbështjellës në sipërfaqe të lakuar



D


Datë	Dita e muajit të një viti të caktuar sipas radhës në kalendar; shifra që shënon këtë ditë. Data e sotme (e djeshme). Në datën 12.8.2019. Letër pa datë. I vë (shënoj) datën. Sa është data sot?
D D=500	Romakët e kanë përdorur shkronjën D për numrin 500 Për shembull: D=500 DL=550 DC=600
Deci	Përdoret si parashtesë për të treguar të dhjetën pjesë të një tërësie. P.sh.: decimetër, decilitër. Shënohet si dm, dl... Presja decimale (presja dhjetore) përdoret për të ndarë pjesën e plotë të numrit decimal nga pjesa jo e plotë (thyesat decimale). Nëse numri përmban presjen dhjetore, atëherë ai është numrër decimal. Shifra e parë në të djathtë të presjes decimale paraqet të dhjetën pjesë, e dyta të qindtën pjesë... P.sh.: $0,4 = \frac{4}{10}$; $2,34 = 2 + \frac{3}{10} + \frac{4}{100} = 2\frac{34}{100}$
Deka	Përdoret si parashtesë për të treguar numrin 10. P.sh.: dekagon – shumëkëndësh me 10 brinjë. Dekagram = 10 gramë
Dekadë	Periudhë kohore prej 10 vjetësh


<p>Dekarti (1596 - 1650)</p>	<p>Filozof francez, shkencëtar, matematikan i njohur për krijimin e një lidhjeje mes gjeometrisë dhe algjebërës, që lejonte zgjidhjen e problemeve gjeometrike me anë të barazimeve algjebrike. Ai është shpallur si filozofi i parë modern.</p>
<p>Deltoid</p>	<p>Katërkëndëshi që ka çifte brinjësh fqinje të barabarta është deltoidi. Gjithashtu diagonalet e tij janë pingule.</p> 
<p>Diagram</p>	<p>Vizatimi, skica që përdoret për të qartësuar diçka. Diagrami i Venit, diagrami i Kerolit</p>
<p>Diametër</p>	<p>Segmenti që bashkon dy pika të vijës rrethore dhe që kalon nëpër qendrën e rrethit.</p> 
<p>Diagonale</p>	<p>Segmenti që bashkon dy kulme jofqinje të një shumëkëndëshi ose shumëfaqëshi.</p> <p>Segmentet që bashkojnë pikat: M dhe J; N me K; O me L janë diagonale.</p> <p>AC diagonale e faqes (katrorit) te kubi AC' diagonale hapësinore (e kubit).</p> 

<p>Digjital</p>	<p>Që shprehet me shifrat 0,1,2,3,4,5,6,7,8,9</p> <p>Ora digjitale</p> 
<p>Dita</p>	<p>Një ditë është një e shtata e javës dhe zgjat 24 orë. Dita fillon në mesnatë.</p>
<p>Diferencë</p>	<p>Ndryshim, dallim.</p>
<p>Drejtëza</p>	<p>Kuptim themelor në matematikë.</p> <p>Gurma që mbetet në fletë, dërrasë të zezë nga lapsi, shkumësi përgjatë skajit të vizores.</p> 
<p>Dimension</p>	<p>Dimensioni paraqet matshmërinë si: gjatësia, gjerësia, lartësia.</p> <p>Drejtëza; vija ka një dimension.</p> <p>Format në rrafsh kanë 2 dimensione: gjatësinë dhe gjerësinë.</p> <p>Format në hapësirë kanë 3 dimensione: gjatësi, gjerësi dhe lartësi.</p> 
<p>Distanca</p>	<p>Paraqet largësinë në mes dy gjërave, dy sendeve. Largesa më e vogël ndërmjet dy vendeve është vijë e drejtë.</p> <p>Distanca matet me njësitë për gjatësi: centimetri, metri, kilometri.</p> 

Distributiv	<p>Ligji distributiv shpreh se si shumëzimi dhe mbledhja mund të përdoren së bashku në disa mënyra p.sh.:</p> $a \cdot (b + c) = a \cdot b + a \cdot c$ $2 \cdot (5 + 7) = 2 \cdot 5 + 2 \cdot 7$
--------------------	---

E

Ekuacion	<p>Dy pjesë, anë të lidhura (të ndara) me shenjën e barazisë, njihet si ekuacion. Ana e majtë dhe ana e djathtë e ekuacionit të barazimit.</p> <p>$6+4=3+7$; $12-y=3$; $2b-7=b+4$.</p>
Ekuivalent	<p>Nënkupton: e njëjtë. Sendet ekuivalente ndoshta duken të ndryshme, por gjithmonë kanë vlerën e njëjtë.</p> <p>Thyesa ekuivalente: $\frac{1}{2} = \frac{2}{4}$</p>
Element	<p>Bashkësia është e formuar prej elementeve, pjesëve.</p> <p>Numri 1 është element i bashkësisë. $\{1, 2, 3, 4\}$.</p>
Eksponent	<p>Eksponenti i shprehjes 5^2 është 2. Gjithashtu eksponenti njihet si tregues i fuqisë. $5^2 = 5 \cdot 5$.</p>
Ekzakt	<p>I saktë, i përpiktë.</p>
Eksperimenti	<p>Veprim i cili mund të përsëritet dhe që mund të ketë rezultate të mundshme.</p> <p>P.sh.: hedhja e zarit: </p> <p>Eksperimenti na ndihmon për të ardhur gjer tek informacionet duke mbledhur të dhëna.</p>

<p>Elipsi</p>	<p>Elipsi është rrethi i rrafshuar, i shtypur që ka dy boshte të simetrisë</p> 
<p>Emërues</p>	<p>Emëruesi i thyesës është elementi i thyesës që është vendosur nën vijën thyesore. Emëruesi i thyesës $\frac{3}{5}$ është numri 5, emëruesi i thyesës $\frac{a}{b}$ është b.</p>
<p>Epsilon</p>	<p>Eε Shkronjë greke që gjen përdorim në matematikë për të shënuar vlera të vogla.</p>
<p>Eratosteni (274 p.e - 196 p.e)</p>	<p>Matematikan grek, i njohur për numrat e thjeshtë dhe përcaktimin e diametrit të Tokës.</p>
<p>Euklidi</p>	<p>Euklidi është matematikan grek i cili ka themeluar shkollën e matematikës në Aleksandri. Ai ka shkruar tekstin më jetëgjatë në matematikë. Ky libër njihet me emrin "ELEMENTS", i cili ka mbledhur bashkë të gjitha idetë dhe teoremat për gjeometrinë e asaj kohe dhe paraqet fillimin e gjeometrisë euklidiane.</p>
<p>Euleri (1707 - 1783)</p>	<p>Matematikan zviceran i cili pjesën më të madhe të jetës së tij e kaloi dhe punoi në Rusi. Ai njihet për zbulimin e temës së njohur si topologji.</p>

F

Faktor	Numrin ose shprehjen algjebrike të shprehur në formë të prodhimit të numrave ose shprehjeve, themi që e formojnë faktorët, si p.sh.: $12 = 2 \cdot 6$
Ferma (1607 - 1665)	Matematikan francez i njohur për teorinë moderne të numrave, teorinë e probabilitetit, gjeometrinë analitike etj.
Fibonaci (1170 - 1240)	Matematikan italian i njohur me numrat e Fibonacit 1,1,2,3,5,8,13, 21,...
Figura	Në gjeometri paraqet formën e mbyllur që fitohet me kombinimin e vijave, pikave rrafsheve.


G

Gama	Shkronjë e alfabetit grek, shënohet γ
Gausi (1777 - 1885)	Matematikan, astronom, fizikan gjerman i cili ka kontribuar në shumë fusha të matematikës dhe të shkencës.
Giga	Shënohet $G=1000\ 000\ 000$
Grad	Është $\frac{1}{100}$ pjesë e këndit të drejtë.
Gram	Është $\frac{1}{1000}$ pjesë e kilogramit.
Grafik	Grafiku është bashkësia e pikave koordinatat e të cilave plotësojnë një funksion (barazim).

GJ

Gjeometria	Kuptimi <i>Geo</i> - tokë, <i>metron</i> - matje. Gjeometria është degë e matematikës që ka të bëjë me matjet, vetitë, marrëdhëniet e pikave, këndeve, formave, sipërfaqeve, trupave.
-------------------	---

H


Harku rrethor	Pjesa e vijës rrethore me dy pika të vijës rrethore. 
Hektar, 100ha=1km²	$\frac{1}{100}$ e km ²
Hekto, h	Parafjalë në sistemin matës që ka kuptimin 100, hl=100l
Hemisfera	Është gjysma e sferës.
Heron	Matematikan grek, njihet me formulën e Heronit me të cilën njehsohet syprina e trekëndëshit kur janë dhënë gjatësitë e brinjëve të tij.
Heksagon	Gjashtëkëndëshi.
Hilbert (1862 - 1943)	Matematikan gjerman me ndikim në shek. XIX-XX. Hilberti ka qenë matematikani më me ndikim në fushën e gjeometrisë pas Euklidit.




Hipotenuza	Është brinja më e gjatë e trekëndëshit kënddrejtë. Hipotenuza gjendet përballë këndit të drejtë.
Histogram	Grafiku i cili të dhënat i paraqet me anë të drejtkëndshave të ndërtuar mbi boshtin x .
Horizontal	Një vijë horizontale në çdo pikë të Tokës është një vijë e drejtë që shtrihet në kënd të drejtë me vertikalen në atë pikë.
Hipoteza	Është kuptim që testohet nëpërmjet hulumtimit ose eksperimentit. Hipoteza është parashikim që testohet me anë të hulumtimit.



Identitet	Në algjebër identiteti është barazimi i cili është i saktë për të gjitha vlerat e ndryshores. Për të paraqitur se barazimi është identitet, përdoret shenja " \equiv "
Inkluziv	Fjala "inkluziv" përdoret për të emëruar diçka që përfshin, ose që është përfshirë diku.
Infinite	Sasi, madhësi e cila thuhet se është infinite po qe se ka madhësi, por nuk mund të numërohet ose të matet në asnjë mënyrë. E pafund ose e pamatshme.
Instrument	Mjet, vegël.
Inverse	Elementi invers i një elementi të një bashkësie ku është përkufizuar një operacion binar, është një element tjetër i po asaj bashkësie, i cili kur kombinohet me elementin origjinal, fitohet identitet. P.sh.: $x+(-x)=0$ (bashkësia e numrave ku është dhënë operacioni i "+")

K

Kalkulator	Pajisje e vogël dore të cilin futen numrat, caktohen operacionet matematikore. Në modelet më të thjeshta operacionet "+", "-", ".", ":". Rezultati paraqitet në ekran.
Kardinal (numri kardinal)	Është numri natyror që paraqet numrin e elementeve të një bashkësie.
Kilogram	Njësi për matjen e masës, $1\text{kg}=1000\text{g}$.
Koeficient	Konstanta që vendoset para ndryshores ose grupit të ndryshoreve. P.sh.: $3x$, $6z$, $7xy$. Koeficientët janë: 3, 6, 7.
Kolinear	Pikat që i takojnë të njëjtës drejtëz.
Komutativ	Operacion komutativ është ai të cilin renditja e dy objekteve në të nuk ka rëndësi. P.sh.: operacioni "+" $2+3=3+2$
Kompas	Mjet me të cilin vizatohet vija rrethore, harku... 
Komplement	Komplementi i një bashkësie A është bashkësia e të gjithë elementëve që i takojnë bashkësisë universale (U) e nuk i takojnë bashkësisë A .

<p>Komplementar (kënde)</p>	<p>Dyshja e këndeve që formojnë këndin prej 90° janë kënde komplementare.</p> 
<p>Kompjuter</p>	<p>Makinë që performon çfarëdo operacioni dhe që shpreh aspektin logjik dhe aritmetik.</p>
<p>Konstant</p>	<p>Është një vlerë që është e pandryshuar sa herë që përdoret për qëllimin e caktuar për të cilin është përcaktuar. Zakonisht është numër, por në disa raste është shkronjë.</p>
<p>Korda</p>	<p>Segmenti, pikat e skajshme të të cilit janë pika të vijës rrethore.</p> 
<p>Koordinata</p>	<p>Çifti koordinativ (x,y), që përcakton pikën në rrafshin koordinativ.</p>
<p>Sistemi koordinativ</p>	<p>Sistemi kënddrejtë koordinativ ose karteziian është dyshja e boshteve numerike (x – horizontal dhe y- vertikal), të cilat janë pingule njëra në tjetrën dhe kanë pikën e fillimit $O(0,0)$ të përbashkët.</p>
<p>Koordinativ - rrafshi koordinativ</p>	<p>Rrafshi te i cili është vendosur sistemi kënddrejtë koordinativ.</p> 

Kubi


Është prizmi i rregullt katërkëndor tek i cili të gjitha faqet janë katrore.

**L**

Linear	Fjala "linear" asocion në vijën e drejtë.
Litër	Njësi për matjen e vëllimit të lëngjeve. $1l=1dm^3$

M


Maksimum	Vlera, sasia më e madhe që është e mundur.
Matematika	Të studiuarit e numrave, formave, strukturave etj. Rrjedh nga greqishtja dhe ka kuptimin “dije”, “njohuri”, “të mësuarit”.
Mediana ose mesorja (statistik)	Numri i mesëm në vargun e radhitur, p.sh.: 4,1,7 mediana është 4 sepse vargu i radhitur është 1,4,7 dhe 4 është elementi i mesëm. Nëse janë dy të këtillë, atëherë mediana është mesatarja e tyre, p.sh.: është dhënë 1,2,3,4,5,6, 8,9 mediana do të jetë (4+5):2
Mediana (te trekëndëshi)	Segmenti që bashkon kulmin me mesin e brinjës përballë.
Mega	Prefiks që paraqet 1000 000=10 ⁶ . Shtohet në fillim të fjalës për të fituar fjalë të re. Sistemi internacional lejon njësitë e reja të formohen nga ato standarde (themeloret) duke shtuar prefiksën në fillim të fjalës. Kanë kuptimin e shumëzuesve. Shënohet me M .
Metri	Njësi për matjen e gjatësisë.
Mikro	Prefiks që paraqet 1 të miliontën pjesë $10^{-6} = \frac{1}{1000000}$, simboli për të është μ
Mili	Prefiks që paraqet 1 të mijtën pjesë, $10^{-3} = \frac{1}{1000}$, simboli për të është m
Miligrami	Njësi matëse për peshë, 1000mg=1g

Milimetri	Njësi matëse për gjatësi 1000mm=1m
Milioni	1000 000=10 ⁶
Minimumi	Vlera më e vogël që është e mundur.
Minuta (e kohës)	Minuta paraqet 1 të 60-ën pjesë të orës.
Minuta (e këndit)	Minuta paraqet 1 të 60-ën pjesë të shkallës.
Moda	Është elementi i vargut që më së shpeshti paraqitet 1,2,3,3,3,5,6,7,7. Moda është 3.
Mozaik	Radhitja e formave 2D zakonisht poligone. Nuk përjashtohen edhe format e lakuara.
Motiv	Elementi bazë me përsëritjen e të cilit formohet një model. 



N



Newton (1643 - 1727)	Matematikan anglez, më i njohur i të gjitha kohërave. Ai gjithashtu ka qenë fizikan, astron, teolog. Ai identifikoi principin e gravitacionit.
Sistemi numerik	Është i formuar nga një bashkësi e simboleve të definuara dhe numrave që ata përfaqësojnë, së bashku me rregullat për të krijuar me këto simbole numra të tjerë më të mëdhenj.
Numër	Është element bazik i aritmetikës, që përdoret për të shprehur dhe për të paraqitur sasi të. P.sh.: 2 lule, 7,8 m, shëno pikën (-3,4).
Numrat natyrorë	Shënohen me shkronjën N . $N = \{1, 2, 3, \dots\}$
Numrat e plotë	Shënohen me Z = $\{\dots -3, -2, -1, 0, 1, 2, 3, \dots\}$
Numrat racionalë	$Q = \left\{ \frac{m}{n}, m, n \in Z, n \neq 0 \right\}$

O




Objekt	Në matematikë, objekte janë numrat, bashkësitë, format gjeometrike etj.
Operacion	Është rregull për përpunimin e një ose më shumë objekteve.
Operator	Është simboli me të cilin shënohet se cili operacion kryhet, +, -, :,
Origjina	Në sistemin koordinativ kënddrejtë, origjina është pikëprerja e boshteve koordinative.
Ortogonal	Dy drejtëza janë ortogonale nëse priten nën kënd të drejtë. 


P

<p>Paralel</p>	<p>Dy ose më shumë drejtëza që shtrihen në të njëjtin rrafsh, janë paralele nëse nuk kanë pika të përbashkëta.</p> 
<p>Paraleloiped</p>	<p>Trupi që ka 6 faqe, të cilat janë paralelograme si dhe faqet e kundërta paralele.</p>
<p>Paralelogram</p>	<p>Katërkëndëshi, i cili brinjët e përballta i ka paralele, diagonalet përgjysmohen. Nuk ka kënd të drejtë dhe nuk ka bosht të simetrisë.</p> 
<p>Paskali (1623 - 1662)</p>	<p>Blaise Pascal - matematikan, fizikan, teolog francez. Një ndër zbuluesit e kalkulatorit mekanik.</p>
<p>Pentagon</p>	<p>Pesëkëndësh.</p>
<p>Perimetër</p>	<p>Nga gjuha latine <i>peri</i>-përreth, <i>metron</i>-matje. Perimetri është gjatësia e kufirit, me të cilën është përcaktuar një formë 2D.</p>
<p>Poligon</p>	<p>Është shumëkëndëshi, që formohet nga një vijë e thyer e mbyllur. Segmentet e vijës së thyer paraqesin brinjët e poligonit, kurse pika e përbashkët e brinjëve fqinje janë kulmet e poligonit.</p>




Popullacion	Në statistikë, popullacioni paraqet tërësinë e elementeve që studiohet me ndonjë metodë statistikore.
Prizmi	<p>Trupi gjeometrik, dy faqet e të cilit janë shumëkëndësja të barabartë dhe u takojnë rrafsheve paralele, kurse faqet tjera janë drejtkëndësja ose paralelograme.</p> 
Probabiliteti	Fjala “probabilitet” do të thotë mundësi, gjasë. Probabiliteti na tregon sa ka mundësi që një ngjarje të ndodhë.
Program	Është bashkësi udhëzimesh të shkruara në gjuhë të veçantë, të cilën kompjuteri mund ta kuptojë, t’i tregojë kompjuterit saktë si duhet të kryhen operacionet e nevojshme.
Ptolomeu (367 - 283 p.e.s)	Matematikan grek, astronom, astrolog dhe gjeograf, i njohur me teorinë për gjithësinë, lëvizjen e trupave qiellorë.
Piramida	<p>Trup gjeometrik njëra faqe e të cilit është shumëkëndësh, ndërsa faqet tjera janë trekëndësja që kanë një pikë të përbashkët.</p> 
Pitagora (570 - 495 p.e.s)	Matematikan, filozof grek. Pitagora është i njohur me teoremën që mban emrin e tij.



R,RR

<p>Reciprok</p>	<p>Numri reciprok është numri që fitohet pas pjesëtimit të numrit 1 me atë numër. P.sh. numri reciprok i numrit 2 është $\frac{1}{2}$, ose 1:2.</p>
<p>Romb</p>	<p>Katërkëndëshi me brinjë të barabarta dhe diagonale që priten nën kënd të drejtë, që njëkohësisht janë boshte të simetrisë.</p> 
<p>Sistemi romak i numrave</p>	<p>Është sistem numerik që përdor simbolet 1=I, V=5, X=10, L=50, C=100, D=500, M=1000, p.sh.: IV=4, IX=9, XXX=30, XC=90</p>
<p>Vija rrethore</p>	<p>Bashkësia e pikave të rrafshit që janë njëlloj të larguara nga një pikë e fiksuar që quhet qendra e vijës rrethore (pika O).</p> 
<p>Rrethi</p>	<p>Bashkësia e pikave të rrafshit të kufizuara me vijën rrethore.</p> 




Rrënja	<p>Rrënja e një barazimi është vlera e cila e plotëson barazimin që është formuar nga shprehja që përmban një ndryshore, e barabartë me zero.</p> <p>$3x-6=0$, $x=2$, 2 është rrënja e barazimit.</p>
Rrezja e vijës rrethore	Segmenti që bashkon qendrën e vijës rrethore me cilëndo pikë të vijës rrethore.
Rrezja e sferës	Segmenti që bashkon qendrën e sferës me cilëndo pikë të sferës.
Rruzulli	<p>Bashkësia e pikave të hapësirës së kufizuar me anë të sferës.</p> 

S


<p>Sekant</p>	<p>Drejtëza që pret vijën rrethore në 2 pika.</p> 
<p>Sekond (i këndit)</p>	<p>1 sekond është këndi që është $\frac{1}{60}$ pjesë e minutës.</p>
<p>Sekond (e kohës)</p>	<p>Sekond (s) është njësi për matjen e kohës.</p>
<p>Sektor</p>	<p>Pjesa e rrethit e kufizuar prej harkut rrethor dhe dy rrezeve me pikë të skajshme të përbashkët dhe pika të skajshme që janë pika të skajshme të harkut rrethor.</p> 
<p>Segment</p>	<p>Pjesa e drejtëzës e kufizuar me dy pika (pikat e skajshme) së bashku me pikat e drejtëzës që ndodhen ndërmjet pikave të skajshme. </p>
<p>SI - Sistemi internacional i njësive</p>	<p>Oficialisht është krijuar në Konferencën Gjenerale XI për peshën dhe matjen të mbajtur në Paris në vitin 1960. SI - Sistemi internacional për njësi, për matje shkencore, me njësi bazë standarde, si metri, kilogrami.</p>
<p>Sigma</p>	<p>Shkronjë greke Σ, σ</p>

<p>Sfera</p>	<p>Bashkësia e pikave të hapësirës njëlloj të larguara nga një pikë e fiksuar.</p> 
<p>Statistika</p>	<p>Përfshin grumbullimin, paraqitjen, përpunimin dhe analizën e të dhënave si dhe nxjerrjen e përfundimeve.</p>
<p>Simbol</p>	<p>Shenjë ose karakter që përdoret për paraqitje konvencionale të një udhëzimi, numri. Ndonjëherë simboli zëvendëson grup fjalësh.</p>
<p>Simetria</p>	<p>Në gjeometri simetria përkufizohet si ngjashmëri mes dy gjysmave të një objekti.</p> 


T

Temperatura	Matet me vlerën që është dhënë në shkallën e dhënë; Celsius, Farenhajt, Kelvin.
Teorema	Pohimi, saktësia e të cilit duhet vërtetuar.
Translacion	Zhvendosja e një objekti pa e rrotulluar, reflektuar ose ndryshuar madhësinë e tij. Zhvendosja përgjatë një drejtëze. 
Trapez	Katërkëndëshi, i cili ka një palë brinjë paralele dhe që quhen bazat e trapezit. 
Trekëndësh	Poligoni me tre kënde është trekëndëshi. 


U

Uniform	Konstante, e njëjtë në të gjitha rastet dhe në çdo kohë, e pandryshueshme.
Union	Unioni i dy bashkësive është bashkësia që i ka për elemente të gjitha elementet e atyre dy bashkësive. Nëse ndonjë element përsëritet tek dy bashkësitë, atëherë në union përfaqësohet vetëm një herë. Simboli U p.sh.: $\{1, 2, 3\} \cup \{2, 3, 4\} = \{1, 2, 3, 4\}$
Bashkësi universale	Është bashkësia që shënohet U , e cila e para përkufizohet (sipas ndonjë rregulle). Ajo i përmban të gjitha elementet e bashkësive të ndërlidhura. 

V

Valid	<p>Një pohim është valid, po qe se ai është i vërtetë dhe mund të vërtetohet duke përdorur koncepte dhe rregulla matematikore.</p>
Variabël	<p>Është symbol (zakonisht shkronjat x,y,z), i cili mund të marrë vlerë nga një bashkësi e dhënë (p.sh.bashkësia e numrave të plotë). Paraqet numër ose sasi të panjohur.</p>
John Venn (1834 - 1923)	<p>Filozof anglez, i njohur si shpikës i diagramit të njohur me emrin e tij.</p>
Diagrami i Venit	<p>Është një grafikë që përdor dy, tre ose më shumë rathë për të paraqitur marrëdhëniet midis dy bashkësive. Ky mjet përdoret kryesisht për të përfaqësuar vizualisht ngjashmëritë dhe ndryshimet midis bashkësive, në mënyrë që fitimi i njohurive për bashkësitë të jetë më i lehtë. Rrathët që mbivendosen kanë të përbashkëta, ndërsa rrathët që nuk mbivendosen nuk ndajnë të njëjtat tipare ose karakteristika.</p>
Vertikal	<p>Drejtëza është vertikale në çfarëdo pikë të rruzullit tokësor, po qe se ajo drejtëz kalon nëpër atë pikë dhe qendrën e Tokës. Gjatë vizatimit drejtëza vertikale paraqitet si drejtëz që ka drejtimin nga lart-poshtë të faqes së vizatimit.</p> 
Vëllim	<p>Vëllimi është pjesë e hapsirës që kufizohet nga një trup. Njësia për matjen e vëllimit është m^3, dm^3, cm^3.</p>

X, XH, Y, Z, ZH

X	Boshti x -abshisa e sistemit kënddrejtë koordinativ në rrafsh është boshti horizontal dhe është koordinata e parë e pikës së paraqitur me çiftin e renditur të numrave.
Y	Boshti y -ordinata e sistemit kënddrejtë koordinativ në rrafsh është boshti vertikal dhe është koordinata e dytë e pikës së paraqitur me çiftin e renditur të numrave.
Z	Bashkësia e numrave të plotë.
Zero	<p>Zero shifra 0. 0 është numri me të cilin nuk paraqitet asnjë sasi, vlerë ose objekt. Zero është numri i plotë që l ndanë numrat pozitiv nga numrat negativ.</p>  <p>Zero e ndryshon vlerën e shifrës, p.sh. 5, 50, 500.</p>

Bibliografia

Zejnullahu. R, Bilalli. S *Përmbledhje deyrash të zgjidhura nga MATEMATIKA 3, për ata që duan të dinë më tepër.* Prishtinë 2012.

Hrvatsko Matematičko Društvo Klokan-Leptirici 2024

Hrvatsko Matematičko Društvo Klokan-Leptirici 2023

Hrvatsko Matematičko Društvo Klokan-Leptirici 2022

Oxford Primary Illustrated Maths Dictionary, Oxford University Press 2019 ISBN: 978019277247 3

Oxford Student's Mathematics Dictionary, Oxford University Press 2013 ISBN: 978019273357 3

Математичко такмичење „Кенгур без граница“ _ 2008. 3 _ 4. Разред, Друштво математичара Србије

Математичко такмичење „Кенгур без граница“ _ 2009. 3 _ 4. Разред, Друштво математичара Србије

Математичко такмичење „Кенгур без граница“ _ 2010. 3 _ 4. Разред, Друштво математичара Србије

Математичко такмичење „Кенгур без граница“ _ 2012. 3 _ 4. Разред, Друштво математичара Србије

Математичко такмичење „Кенгур без граница“ _ 2013. 3 _ 4. Разред, Друштво математичара Србије

Математичко такмичење „Кенгур без граница“ _ 2014. 3 _ 4. Разред, Друштво математичара Србије

Математичко такмичење „Кенгур без граница“ _ 2014. 3 _ 4. Разред, Друштво математичара Србије

Математичко такмичење „Кенгур без граница“ _ 2015. 3 _ 4. Разред, Друштво математичара Србије

Математичко такмичење „Кенгур без граница“ _ 2016. 3 _ 4. Разред, Друштво математичара Србије

Математичко такмичење „Кенгур без граница“ _ 2017. 3 _ 4. Разред, Друштво математичара Србије

Математичко такмичење „Кенгур без граница“ _ 2018. 3 _ 4. Разред, Друштво математичара Србије

Математичко такмичење „Кенгур без граница“ _ 2019. 3 _ 4. Разред, Друштво математичара Србије

Математичко такмичење „Кенгур без граница“ _ 2020. 3 _ 4. Разред, Друштво математичара Србије

Математичко такмичење „Кенгур без граница“ _ 2021. 3 _ 4. Разред, Друштво математичара Србије

Математичко такмичење „Кенгур без граница“ _ 2022. 3 _ 4. Разред, Друштво математичара Србије

Математичко такмичење „Кенгур без граница“ _ 2023. 3 _ 4. Разред, Друштво математичара Србије

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

51:373.3(076)=18

ILJAZI, Teuta

Matematika mendimtare / Teuta Iljazi. - Koçan : Evropa 92, 2024 (Koçan :
Evropa 92). - 128 стр. : илустр. ; 26 см

Библиографија: стр. 127

ISBN 978-608-5035-08-3

a) Математика -- Основно образование – Задачи

COBISS.MK-ID 64801541

MUNDËSUAR NGA:

kipper

Ky libër dhurohet dhe nuk është i destinuar për qëllime përfitimi financiar.
Çdo shitje apo keqpërdorim i mundshëm, ndëshkohet me ligj!